Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 10 (30). TETOR 2008. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

AURORA GROUP

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet

Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

HISTORI

Masakrat serbe të vitit 1913

NGA: **MOISI MURRA - FAQE 13**

PORTRET

Ali Bana, një dosje e bardhë që duhet hapur

NGA: **NAIM PLAKU - FAQE 7**

FEJTON

Xha Hasani dhe kapsllëku i gazetarëve

NGA: **RAMIZ GJINI - FAQE 5**

GJUHËSI

Për pastërtinë e gjuhës së medias

NGA: **Prof. dr. HAJRI SHEHU - FAQE 14**

EDITORIAL

Ata vlejnë!

Nga BUJAR KAROSHI

"Vlen 111" ishte mesazhi im i celularit në fundjavën e shkuar, pas shumë kohësh që s'kisha shkruar mesazhe për emisionet televizive. Dhe këtë mesazh, si rrallëherë, e shkruam me nxitim e me ngut familjarisht për fëmijët e Cirkut të Peshkopisë, që nën drejtimin e Agron Strazimirit na bënë të ndjehemi krenarë.

Ata vlejnë me të vërtetë. Ata vlejnë shumë, më shumë se mosha! Ata vlejnë më shumë se gjithë zyrtarët e shtetit në Dibër, më shumë se gjithë intelektualët dibranë të marrë së bashku. Ata vlejnë, jo vetëm se na bëjnë të ndjehemi krenarë, por se na tregojnë se mes nesh ka akoma njerëz që ruajnë vlera njerëzore, ruajnë përkushtimin dhe vullnetin për t'i bërë gjërat me dashuri dhe zemër!

Vikena Kamenica, në natën e parë të spektaklit "Ti vlen", pasi pa talentin dhe mrekullinë e katër fëmijëve të talentuar dibranë, nga 25 që ka aktualisht trupa e cirkut, i vlerësoi ata dhe kujtoi se Peshkopia ka dhe një "teatër". Gjithmonë kishim dëgjuar që sukseset e të rriturve u hapin rrugën të rinjve, por të shohësh të vegjlit dhe të kujtosh për të rriturit është e rrallë në këtë botë. Dhe fëmijët e cirkut, me talentin dhe përkushtimin e tyre, na kujtuan se Peshkopia ka (kishte) edhe një teatër. Po, Peshkopa ka një teatër, por jo vetëm atë. Peshkopia ka një Pallat të madh Kulture që ia ka zili çdo qytet në Shqipëri. Por mbi të gjitha, Dibra mban në gjirin e saj talente të fshehura, që kanë nevojë për pak kurajo dhe mbështetje.

Fëmijët e cirkut nuk na kënaqën vetëm me talentin e tyre, por ato treguan se "sponsorizimet" nuk janë parësore për një sukses. Parësore është vullneti, pasioni dhe dëshira, që këta fëmijë na e treguan më së miri. Por nuk duhet të mungojë dhe mbështetja financiare, e cila nuk duhet të jetë sporadike, as nga qeverisja vendore apo vetë prindërit. Mbështetja duhet të jetë mbarëdibrane, kudo që janë, me të gjitha mënyrat, me mbështetje morale e financiare, që nesër të mos themi sërish se i kishim mes nesh, por të krenohemi se i kishim, i mbështetëm dhe i kemi. Sukseset e tyre do na bënin të ndjeheshim krenar më shumë, duke qenë të ndërgjegjshëm se lamë kështu në kulturën dibrane një dëshmi të kurajës dhe iniciativës progresiste.

Ata e treguan çfarë mund të bëjnë, ne duhet të tregojmë si mund t'i ndihmojmë.

Ata bënë të tyren, në duhet të bëjmë tonën. Dhe e jona është mbështetja e gjithanshme, që nga pushteti vendor e deri te institucionet kulturore qendrore, private apo jo, në mënyrë që ta kthejmë trupën e fëmijëve të cirkut të Peshkopisë në Trupën Kombëtare të Cirkut Shqiptar.

Secili prej nesh mund ta dëshmojë këtë: Shkruaj "VLEN 111" dhe dërgojë në 15192.

Teatri ul perdet, Oda hap dyert



Përfundoi Festivali i shtatë "Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2008". Çmimin "Sulejman Pitarka", e fitoi Teatri i Gjakovës, regjisorja më e mirë u shpall u shpall Driada Dervishi e Durrësit, ndërsa aktori dhe aktorja më e mirë u vlerësuan Muharrem Hoxha dhe Adriana Matoshi.
Në Odën Dibrane 15 shoqëri kulturore nga Kosova, Maqedonia, Shqipëria dhe Rumania konfirmojnë pjesmarrjen

SPECIALE NË FAQET 8,9,10,11,12

IDE - DEBAT: Shkruan SHEHAT MARKU, Dibër e Madhe

UNIVERSITETI I DIBRËS do të rrezatojë të mira gjithëkombëtare

- Mos u kënaqni se e lançuat idenë dhe mbaruam punë. Jo zotërinj! Duhet ta realizojmë patjetër; kjo ide mbulon një territor të madh prej Mati deri në Tetovë, Struge deri në Elbasan; nuk është pasuri vendore, por kombëtare.
- Pohoj me bindje të thellë individuale dhe me mendimin e intelektualëve dibranë se Dibra është në vendin e duhur, është në truallin e vet, do të rrezatojë me këtë universitet për të mira gjithëkombëtare, si i ka pasur hije gjithmonë.
- Apeloj ndër politikanë, institute shtetërore qeverisëse, shoqëri qytetare t'i dalim zot kësaj ideje sa më parë, sepse ajo prodhon zhvillim për mirëqenie të gjërë kulturore, ekonomike dhe intelektuale.

Faqe 2

AKTUALITET

Rruga e Arbërit kërkon një bashkëpumin më të mirë mes Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë

Nga: **REXHEP TORTE** - Faqe 3

"Në vazhdimësi të konstatimeve të lartpërmendura them me të drejtë historike se **urtësia dibrane** me urtakët e saj nuk është rastësi, **është me peshë mbarëkombëtare** që me Skënderbeun, i cili rrezatoi me urtësi të pashembullt për atë epokë historike"

UNIVERSITETI I DIBRËS
do të rrezatojë të mira gjithëkombëtare

"Rreshtohem përbri idesë së Hysen Ukës e bashkëmendimtarëve të tij, për Universitetin e Mendimit Shqiptar"

Nga SHEHAT MARKU

Marr të drejtën të rreshtohem përbri idesë të z. Uka nga këto këndvështrime:

Së pari, ka prodhuar ide madhore duke konsultuar shokë dhe miq të cilët i quan bashkëmendimtarë. Është ide e pjekur.

Së dyti jep një shpjegim bindës për të vërtetetën e urtësisë dibrane.

Së fundmi mendoj unë se kjo ide nuk është e rastësishme, del nga një trashëgimi shekullore e këtij këndi i etnisë kombëtare, vlerë që meriton studime universitare, e cila do të flasë shumë për civilizimin shekullor të kombit tonë në Ballkan, si interes shumë dimenzional për kombin në tërësi.

Ideja jotë z. Uka është objektive, me të drejtë historike në vazhdimësi. Në këtë kuptim ka themele për nje ngrehinë madhështore që do të prodhojë shkencësisht shumë të mira e mirësi kombëtare. Do të vlejë së pari për politikën kombëtare dhe për politikanët tonë në çdo kohë dhe hapësirë.

Jam i sigurtë se një politikë kombëtare e ushtruar prej politikanëve pa vizion që nuk kanë strategji të mbështetur në historinë e trashëguar, për të ardhmen, të cilës nuk i referohen, nuk mund të bartin zgjidhje për të tashmen dhe vazhdimësinë progresive të etnisë tonë kombëtare. Kështu p.sh. për të pabërat që duheshin bërë nga politikanët tanë gjatë historisë janë të pakuptimta dhe në kundërshtim të prerë me trashëgiminë tonë historike. mbasi kultura politike është prodhim i kulturës historike masive të urtësisë kombëtare, të cilët me cilësi vizionarësh dhe me ide kombëtare të pavdekshme sigurisht do të realizoje nevojat e kombit, i ngjitet lartë civilizimit dhe urtësisë kombëtare, është pra prodhim i konsensusit historik me vazhdimësi për çdo kohë dhe për çdo hapësirë.

Në vazhdimësi të konstatimeve të lartpërmendura them me të drejtë historike se urtësia dibrane me urtakët e saj nuk është rastësi, është me peshë mbarëkombëtare që me Skënderbeun, i cili rrezatoi me urtësi të pashembullt për atë epokë historike. Me bashkimin e princave të principatave shqiptare në Lezhë për organizim ushtarak për mbrojtje nga okupimi i tërbuar osman është vlerë e mençurisë së pashembullt në Evropën e asaj kohe. Me sukses organizoi vetëmbrojtje për 20 vjet me rradhë.

Evropa e krishterë e atëhershme kurrë nuk pati fuqi të bashkohet për vetëmbrojtje nga okupimi osman, e cila pësoi nga ky tërbim i okupuesit okupim gati gjysmën e territorit të saj.

Më tej, pas okupimit pesëshekullor në kryengritjen e famshme gjithëshqiptare, në qeverinë e parë të Lidhjes së Prizrenit ju besua koordinimi i kësaj qeverie një dibrani. Në vazhdimësi në kuvendin gjithëshqiptar të Vlorë, kryetar u vu dibrani.

Nga ky rreshtim i bërë historisë kombëtare shkurt dhe me fakte të pamposhtur del se konsensusi politiko-partiak ndër nahitë shqiptare të bashkuar për liri kombëtare ndër këto epoka i është besuar dibranit ta realizojë në ato rrethana. Kjo ngren peshë me madhështi të vecantë prodhimi mendor shqiptar, prandaj konstatoj se Universiteti i Dibrës, Shtëpia e Mendimit Shqiptar, është me interes dhe i qëlluar

Në këtë trashëgimi urtësia dibrane ka ditur ta quajë shqiptare çdo vlerë me interes të çdo shqiptari ndër këndet e natyrshme etnike të saj. Ka ditur të revolucionarizojë me civilizim të kohëve në periudha historike, ka funksionuar me vlera tërësisht identike shqiptare.

Nëpërmjet këtij universiteti do të dalin shumë e më shumë burime shkencore të sigurta dhe të dëshiruara se Shtëpia e Mendimit Shqiptar në Dibër do të pasurojë të tashmen dhe të ardhmen me fakte për të mirat civilizuese kombëtare që do të ushtrojnë të drejtë qytetare për kombin në tërësi

Pohoj me bindje të thellë individuale dhe me mendimin e intelektualëve dibranë se Dibra është në vendin e duhur, është në truallin e vet, do të rrezatojë me këtë universitet për të mira gjithëkombëtare, si i ka pasur hije gjithmonë.

Nga ky rreshtim i bërë historisë kombëtare shkurt dhe me fakte të pamposhtur del se konsensusi politiko-partiak ndër nahitë shqiptare të bashkuar për liri kombëtare ndër këto epoka i është besuar dibranit ta realizojë në ato rrethana. Kjo ngren peshë me madhështi të vecantë prodhimi mendor shqiptar, prandaj konstatoj se Universiteti i Dibrës, Shtëpia e Mendimit Shqiptar, është me interes dhe i qëlluar përbrenda mbase flet vetë. Konsenzusi i harmonizuar i brendshëm shqiptar ndër këto epoka ka qenë dhe mbetet vlerë e një populli të civiziluar me vlera jo vetëm Ballkanike, por edhe më gjërë, që prodhojnë të drejta reale gjithmonë të freskëta.

Jam dakort tërësisht me ju dhe idenë që keni publikuar botërisht, z Uka duke thënë se është koha e fundit që kjo ide të promovohet, të realizojmë projekt real dhe të realizueshëm me çdo kusht. Është pra me vlera madhore patriotike për të gjithë shqiptarët. Me të vetmin qëllim pozitiv se trashëgimia e urtësisë dibrane ka pasur dhe do të ketë të drejtë qytetare gjithëshqiptare. Kurorëzohej me shumë dashuri e bukura kombëtare me urtësinë e saj prej kujtdo që ka rrjedhë dhe rrjedh pa pra nga trojet tona etnike.

Progresin e vyrtyteve të dala dhe të afirmuara kombëtare kanë ushtruar përgjithmonë vlerat tona pa kurrfarë ngarkesash hipoteke krahinore e fetare të trojeve etnike. Me shumë respekt dhe dashuri ka nderuar njerin shqiptar me vlera kombëtare. Në këtë trashëgimi urtësia dibrane ka ditur ta quajë shqiptare çdo vlerë me interes të çdo shqiptari ndër këndet e natyrshme etnike të saj. Ka ditur të revolucionarizojë me civilizim të kohëve në periudha historike, ka funksionuar me vlera tërësisht identike shqiptare.

Duke pasur parasysh këto pak vlerësime të numëruara më lartë, mendoj i bindur se me të vërtetat e bëmave historike është shtëpi e mendimit gjithëshqiptar. Sigurisht se nëpërmjet këtij universiteti do të dalin shumë e më shumë burime shkencore të sigurta dhe të dëshiruara se Shtëpia e Mendimit Shqiptar në Dibër do të pasurojë të tashmen dhe të ardhmen me fakte për të mirat civilizuese kombëtare që do të ushtrojnë të drejtë qytetare për kombin në tërësi. Tërësisë etnike i është bërë e padrejtë historike nga të fuqishmit ndër epoka të ndryshme. Ajo vetë i ka vënë në shënjestër këto të padrejta si vepra të dënueshme të të fuqishmëve, e cila pret për gati një shekull të të drejtës së civilizimit botëror, i cili pjesërisht tregoi largpamësinë e dëshirueshme që këto të padrejta historike kërkojnë pa vonesë përmirësimin e tyre. Kultura civilizuese masive në këto transformime bashkëkohore në botë me ngulm trajton mënyrën e keqe të politikëbërjes nga e kaluara e politikëbërjes konspirative e interesave të blloqeve të ndryshme. Tani vazhdimisht kërkon dekonspiracion të këtyre politikave, të harmonizohet me transparencë për interesa globale të sistemit të ri në rindërtim si vlerë e pranuar, e cila siguron shpresa për paqe konstante për botën në tërësi; e mirë e vetme për njeriun e lirë të të sotmes dhe të së ardhmes. Duke mos lënë molekula të kryposura jo më larg se sa para një shekulli të sundimeve ideologjike duke përcarë kombet, të cilat shpërthejnë papritmas me tensione të padëshiruara dhe në kundërshtim me paqen që është jo vetëm shoqërore por me rëndësi bazike se ajo i takon njeriut të lirë, tregut të lirë dhe civilizimit botëror për paqe që e do dhe e dëshiron domosdoshmërisht popujt e saj.

Në këtë kuptim politika e politikanëve që ju referohen të drejtave bazike nga e kaluara mund të ndërtojnë ardhmëri për njeriun kombëtar, vetëm atëherë kur kjo e drejtë i ka takuar dhe i takon, realizimet e saja në tërë etnikumin e tij nuk mund të mjergullohet me politikë të pa afat, hiç me pak me politikanë mafioz dhe të korruptuar, të cilët nuk i takojnë njeriut të lirë dhe assesi atij kombëtar. Këtë e tregoi më së miri në këtë shekull lufta e fashizmit serb në ballkan, e cila ngriti kombet e lira të civilizuar në armiqësi të drejtpërdrejtë nga kjo e keqe njëherë e përfunduar, që mund të sillte vetëm gjak dhe gjakderdhje të pafundme. Mbase popullit shqiptar i takonte liria në territoret e tija, nga politika e djallëzive bllokiste e cunguar dikur aty ngeli e paluhatur me kulturë dhe territor të pandryshuar.

Kjo e vërtetë e kombit tim fillon prej me okupimin e perandorive romake, bizante, sllavo-serbe, turke të cilat nuk kanë pasur mundësi që vlerat tona kombëtare ti zëvendësonin me të vetat. Pra e vërteta jonë kurrë nuk mund të plaket. Për liri ky komb vërtetoi botërisht se i jep shpirtin si me lindë për së dyti. Me këto do tu kallim datën pretendimeve okupuese edhe në kohën e sotme që nuk mund të kenë jetëgjatësi.

Pohoj me bindje të thellë individuale dhe me mendimin e intelektualëve dibranë se Dibra është në vendin e duhur, është në truallin e vet, do të rrezatojë me këtë universitet për të mira gjithëkombëtare, si i ka pasur hije gjithmonë.

Mos u kënaqni se e lançuat idenë dhe mbaruam punë. Jo zotërinj! Duhet ta realizojmë patjetër; kjo ide mbulon një territor të madh prej Mati deri në Tetovë, Struge deri në Elbasan; nuk është pasuri vendore, por kombëtare.

Apeloj ndër politikanë, institute shtetërore qeverisëse, shoqëri qytetare t'i dalim zot kësaj ideje sa më parë, sepse ajo prodhon zhvillim për mirëqenie të gjërë kulturore, ekonomike dhe intelektuale.

Posta e Rruga Arbërit

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Agron Tufa, Ramiz Gjini, Selman Mziu, Xhelal Roçi, Kujtim Boriçi, Beqir Sina, Moisi Murra etj., se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Redaksia:
Në Dibër:
Rexhep Torte
Në Athinë:
Abdurrahim Ashiku
Në Itali:
Selman Mziu
Në New York:
Beqir Sina
Në Tiranë:
Prof. Dr. Bashkim Lleshi,
Naim Plaku

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. (04) 2233 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

aktualitet

Rruga e Arbrit kërkon *një investim më të madh dhe* **një bashkëpumin mes Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë** *për t'i bashkërenditur aktivitetet dhe ndoshta edhe për të patur një financim të përbashkët.*

Matjanët nuk e duan Skënderbeun

Vazhdimisht mjaft studiues matjanë kanë hedhur idenë se heroi ynë kombëtar është me origjinë nga Mati duke kundërshtuar kështu dhe vetë profesorin e nderuar Kristo Frashëri. Për këtë kanë bërë dhe replika në media të ndryshme me mjaft figura të njohura që janë marrë gjatë me figurën e Skëndërbeut. Në qendër të qytetit të Burrelit një bust i heroit tonë kombëtar Skëndërbeu ka vite që është vendosur.Fakt është se pikërisht edhe në vitin e rebelimit të madh në 1997 ku u shkatrrua çdo gjë në qytetin e Burrelit, busti i Skëndërbeut nuk u cënua fare. Krejt ndryshe po na ndodh tani në vitin 2008 ku me një vendim të këshillit bashkiak është vendosur që të hiqet Skëndërbeu e të vendoset Ahmet Zogu.Çfarë paradoksi!? Edhe kur Ahmet Zogu u bë mbret, pretendonte se kishte etnogjenezën nga familja mbretërore e Skëndërbeut, pasi ai e dinte mirë se nuk kishte ndonjë gen tjetër me origjinë familje mbretërore.Lidhur me këtë vendim absurd u shpreh në media dhe kryetari i bashkisë zoti Skëder Lleshi, thua se ky kishte pushtet të bënte gjithçka:

-Do ta heqim bustin e Skëndërbeut pasi ai është i vogël për një shesh me përmasa të mëdha siç është sheshi kryesor i Burrelit dhe do ta vendosim diku në një vend tjetër. Skëndërbeu këtu është pa kalë dhe bustin e tij e zënë dhe pemët që janë rreth e qark dhe ai mezi duket nga larg.Për të bërë një bust tjetër të Skëndërbeut me kalë kushton dhe ne nuk kemi mundësi financiare për këto.Janë mbledhur fonde për të ngritur një përmendore të madhe të Ahmet Zogut në këtë shesh.Për këtë kemi marrë dhe mendimin e historianëve. Presim të prononcohen vetë qytetarët për zhvendosjen e bustit të Skëndërbeut megjithëse këshilli bashkiak ka vendosur.Në media pamë se vetë qytetarët matjanë u prononcuan të cilët e quajtën këtë vendim një tradhëti kombëtare.

Atëherë me të drejtë shtrohet pyetja: Çfarë do më shumë këshilli bashkiak i Burrelit?

"Për momentin nuk ka ndonjë financim konkret për Rrugën e Arbrit, por shpresojmë që në një të ardhme të afërt do të ndajmë edhe mjete financiare, sepse është fakt që kjo rrugë do ta shkurtojë qarkullimin e dibranëve por edhe qarkullimin e lirë të dy vendeve"

Minatorët e Bulqizës në protestë

Më datën 14 tetor minatorët e Bulqizës u ngritën në një protestë në qendër të qytetit. Bashkë me minatorët u bashkuan dhe qytetarë të tjerë të qytetit të Bulqizës.Në mbështetje të tyre kishte ardhur dhe zoti Kolë Nikolli kryetar i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë.Në pankartat e shkruara minatorët kërkonin nga qeveria uljen e moshës së pensionit si dhe statusin e minatorit.

-Protestat do të përshkallëzohen në të gjitha zonat mineral mbajtëse u shpreh zoti Kolë Nikolli.Qeveria po diskretiton minatorët me këtë heshtje që po tregon.

"Jemi njerëzit që i kemi dhënë më shumë se kushdo ekonomisë së vendit, u shpreh një minator, dhe sot jemi më të diskretituarit. Punojmë në kushte tepër primitive dhe paguhemi fare pak.Akoma nuk kemi një statut të veçantë si punëtor nëntoke. Të dalin minatorët që gërmojnë thellësive të nëntokës në pension në moshën 65 vjeç, kësaj i thonë vdis poshtë në zgafellat e galerive. Shteti hesht, thua se ai nuk ekziston fare



për ne.Çmimi i kromit po rritet në tregjet e huaja, por ai mbush xhepat e pronarëve falë djersës dhe gjakut tonë.Për ne nuk do të ia dija askush, as vetë shteti. Sa keq! Vërtet sa keq është katandisur kjo shtresë që ka gërmuar një jetë të tërë në thellësitë e nëntokës shqiptare", thanë disa nga minatorët gjatë protestës

Zv. kryeministri i Maqedonisë Abdylaqim Ademi dhe kryebashkiaku i Gjakovës Pal Lekaj vizituan Dibrën e Madhe

Rruga e Arbërit kërkon një bashkëpumin më të mirë mes Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë

Në kuadër të Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2008", të Dibrën e Madhe e vizituan Abdylaqim Ademi, zv/kryeminisater i Maqedonisë dhe z. Pal Ukaj, kryetar i Komunës së Gjakovës.

Abdylaqim Ademi, për mediat deklaroi se "Ne si pushtet qëndror, duke patur parasysh nevojën qytetarëve të Dibrës që të kenë shërbime kualitative, dhe faktin që të punësuarit në Komunën e Dibrës të kenë kushte më të mira për punë, u angazhuam në mënyrë të drejtpërdrejtë që të ndajmë mjete për Komunë e Dibrës. Në njërën nga seancat e kaluara kemi ndarë 20 milionë denarë për ndërtimin e objektit të ri të Komunës së Dibrës. Shpresojmë që qytetarët e Dibrës bashkë me administratën e komunës së Dibrës të kenë një objekt bashkëkohor, me të vetmin qëllim që qytetarëve tu ofrojnë shërbime sa më të mira. Sigurisht që ky nuk do të jetë investimi i fundit për Dibrën. Në kuadër të projekteve investuese të Qeverisë së Maqedonisë, do të ketë edhe projekte të reja të cilat shumë shpejt do t'i bëjmë publike".

Në pyetjen se çka ka ndërmarë Maqedonia për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, ai u përgjigj se: "Ndërtimi i Rrugës ë Arbërit është një kërkesë e kahmotshme jo vetëm e dibranëve. Rruga e Arbërit kërkon një investim më të madh dhe një bashkëpumin mes Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë për t'i bashkërenditur aktivitetet dhe ndoshta edhe për të patur një financim të përbashkët. Për momentin nuk ka ndonjë financim konkret, por



Në foto: Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe, Argëtim Fida, zv/kryeminisatri i Maqedonisë, z. Abdylaqim Ademi dhe deputetja e Dibrës së Madhe në Parlamentin Maqedonas, znj. Luljeta Marku, gjatë takimit me gazetarët

shpresojmë që në një të ardhme të afërt do të ndajmë edhe mjete financiare, sepse është fakt që kjo rrugë do ta shkurtojë qarkullimin e dibranëve por edhe qarkullimin e lirë të dy vendeve".

Lidhur me ndikimin e BDI-së për njohjen e Kosovës nga Maqedonia, Ademi shtoi se: "Nëse unë them se nuk kemi ndikuar, sigurisht që askush nuk do të besojë. Unë nuk dëshiroj që vendimin që ka marë Qeveria e Republikë së Maqedonisë për ta njohur Pavarësinë e Kosovës ta shndërojmë vetëm në interes të një subjekti politik, të një bashkësie etnike, por në radhë të parë duhet ta shohim një interest të përgjithshëm të shtetit të republikës së maqedonisë. Prandaj këtë vendim e konsiderojmë si një vendim në kohën e duhur, si një vendim për të kontribuar në raportet e mira mes dy vendeve fqinje në radhë të parë si vendim jo në kundërshtim me vendet në rajon ose në kundërshtim me Serbinë. Prandaj edhe reaksionet që vijnë nga Serbia për ne janë të pa arsyeshme dhe besojmë se shumë shpejt edhe ata do ta kuptojnë se Kosova e Pavarur tani më është një realitet dhe se këtij lealiteti nuk mund t'I iket".

Abdylaqim Ademi përshëndeti njëkohësisht edhe aktorët, regjisorët, kritikët dhe publikun. "U siguroi se Qeveria e Maqedonisë nga viti i ardhshëm do ta mbështesë këtë aktivitet kulturor në Dibër duke ndarë edhe mjete financiare" - theksoi ai.

Gjatë kësaj dite u takuan edhe Argëtim Fida, kryetar i Dibrës së Madhe dhe Pal Leka, kryetar i Gjakovës.

Argëtim Fida gjatë mirëseardhjes, theksoi se:" Vëllazërimi mes Dibrës dhe Gjakovës është në të gjitha dimensionet,por ai kulturor është ai që paraprin. Homologu im solli shumë informata inkurajuese për pjesën e tij të mandatit disamuajsh në Gjakovë. Kjo na gëzo së tepërmi dhe vetë fakti se ai ka ardhur në qytetin e vëllazëruar".

Pal Leka, kryetar i komunës së Gjakovës, në fjalën e tij, shtoi se:" Për mua është kënaqësi që gjendem në Dibër.Takimet me kryetarin e Dibrës kanë qenë vëllazërore dhe i kanë kontribuar bashkëpunimit mes dy komunave tona. Unë e falenderova për mikpritjen vëllazërore dhe u gëzova për tërë ato të arriturat që janë bërë në Dibër. E ndjej veten si qytetar i Dibrës, si në shtëpinë time, sepse këtë na e ka mundësuar binjakësimi mes Gjakovës dhe Dibrës. Unë u falenderova edhe për njohjen e Kosovës nga Maqedonia, ndikimin e BDI-së, përgjegjësinë që e ka mërë nga qytetarët e Maqedonisë dhe që ka ndikuar që njohja të bëhet në momentin e duhur, në momentin kur e ka pritur tërë kombi shqiptar. Për mua kjo është një mbështetje në proceset tona pozitive. Dibra ka një pozitë mjaft të mirë, që duhet t'i gëzohemi edhe ne, por sidomos qytetarët. Ndryshimet pozitive të bëra nga pushteti vendor dhe bashkëpunimi mes dy komunave tona ka hapur hapësira si në bashkëpunimin kulturor ashtu edhe në zhvillimin ekonomik me mbështetje të ndërsjellë. Do të hartojmë projekte të përbashkëta të zhvillimit ekonomik dhe kjo do të ndikojë dukshëm edhe në krijimin e mundësive për punësime. Kjo rrugë u print të gjitha proceseve poziitive në favor të qytetarëve të dy komunave", tha Leka.

Rexhep TORTE

Rruga Arbërit nr. 30

Dy opinione, *njëri nga një emigrant që vjen herë pas here në Shqipëri dhe shikon me dhimbje moszhvillimin dhe tjetri për një drejtues që përpiqet çdo ditë të realizojë ndryshimet...*

opinione

Përse nuk mund të kthehemi në atdhe?

Nga: **Dr. SELMAN MËZIU**

Sapo shkelim në tokë befasohemi nga pluhuri, grimca dheu e papastërtit që i thithim pa dëshire e na veshin trupin me një shtresë të hollë duke i ngjarë një mulligjiu të kulturuar, llogjikisht edhe rrugët e frymarrjes e paretet e mushkrive, e sytë më përloten nga kjo turtur shëndet shkatërruese.

Biologët do të gjejnë në këto hapsira fusha të reja studimi, për shembull:sa është peërqindja e pisllekut në aparatin trunor, po në gjakun e botës shtazore e njerzore që lëviz në venat e arteriet. Edhe aparati gjethor dhe i gjelbërt i bimësis vuan nga sëmundja e azmës në këto mjedise super ajër ndotura, të Tiranës, Durrësit, Elbasanit etj

E si të kthehemi?

Peisazhet e trishtuesheme na rrënqethin mishtë. Ndërtime të pa kritershme, me rrugica të ngushta sa për të kaluar një mushkë, me një arkitekture të shthurur pa shije e të ardhme se mëndja e lapsi i arkitektit nuk njihen ose kushtojnë shumë. Rrugë pa emra.shtëpi.palate, hyrje, pa numera, e si rrjedhojë pa adresa, një katrahu e vërtetë. Shohim ndonjë shkollë, kopsht çerdhe, fushë futbolli, tenisi, kopeshte të gjelbëruar me lojra për fëmijë ngado që shkuam. Shohim kazana të mëdhenj mbeturinash, të stermbushur, plasmase kartona letra etj të ngjyrave e madhësive të ndryshme, në çdo kënd, përrenj malor apo buzë lumenjsh anash rrugësh, shetitoresh etj. E ndjejmë një arom kalbësirash në vend të luleve, por nuk përfundon me kaq, natën me shpon hundën era e djegjeve të kazanave të plehërave, apo grumbujt e mbeturinave ku digjen e tymosin ditë, natë. .ç'katastrofe, ekologjiko-shpirterore e morale.

E si të kthehemi?

Në autostrade, nuk mund të udhëtojme sipas kërkesave të saj, është frika e realiteti i saj në trajtën e nj tufe delesh apo dhishë që mund të më shfaqen papritur në mes të sajë, një kal, mushke, gomare, apo tufë derrash, një biçikletë apo motor të cilat mund të na ndalojn të rrahurat e zemrave. Ku është gardhi kufizues? Ku janë rregulloret e ligjet që disiplinojne këto lëvizje kaotike.

Në rrugët e kategoris së parë që fatkeqësisht i quajnë autostrada, udhëtojmë me dyshime, shohim shumë rrallë tabela të rregullave të qarkullimit rrugor, si shpejtësia e kshilluesme, maksimale, kthesa, degëzim etj. Në rrethqarkullimet dhjetra makina nuk dinë se kush ka përparësi, e fillojnë sharjet bërtitjet, ndërsa freksioni e frenat e makinave vuajnë pa masë e shkatërrohen shumë më shpejtë se gomat që priten nga paretet ansore të asfalteve të vjetera ose të pacilësishme, apo rrugëve të pasfaltuara kurrëndonjëherë me gropa të përmasave të ndryshme që të sjellin të vjellura të njëpasnjëshme, dhimbje koke.

Shqetësime të cilat i kushtojnë shumë shëndetit e një humbje kohe me përmasave të pallogaritshme duke e kthyer kohën ne një vlerë me bronxin.

Esi mund të kthehemi?

Dëshprimi na zvoglon metabolizmin qelizor kur në plazhin e Durrësit, shohim në rërën e sajë me shtrirje të gjërë, kartone, plasmase, shishe të thyera, mbeturina biologjike si lëvore shalqini e bostani, lëkura specash, mollësh, domatesh, bamjesh .Gjejmë ndonjë koshë plehrash por ato janë të zemruar se askush nuk iu afrohet ti rrespektojë. Ato duken sikur thonë : Jam këtu në sherbimin tuaj.

Ndërsa jo rrallë shohim fëmije që hedhin këto mbeturina në det, e me ç'far të luajnë kur askush nuk ka menduar për kënde lojrash. Ç'faqkeqësi?

Familjet që kanë kursyer gjithë vitin për të pushuar, i ndjekin pas pamje të hidhura trishtuese e papastërtive, me togjet e mbeturinave erembytëse të cilave iu shtojnë streset, dëmojne shëndetin. E nuk mjaftojnë vetëm këto. Zhurmat e pa kontrollueshme, të muziçistëve të barëve, restoranteve e diskotekave të cilat nuk dinë të ndalen për gjithë natën, nuk të qetësojne përkundrazi të gërvishtin trurin e të shqetësojne pa kufi. Ku ta gjejmë qetësine, shërimin, argëtimin e familjeve tona?

E si mund të kthehemi ?

Ndërsa energjia eletrike është bërë apoteoza e shekullit të njëzete e njëtë si për misrin në epokën Migjeniane. E kudo i madh e i vogël thërret me një zë të ngjirur, të mbytur e të sakatuar nga mjerimi : pakë dritë, pakëz dritë.

Me përtese e me shumë turp, kërkomë të na bëjë dritë pisha e kandili, ndërsa Anglia para disa vjetësh jetoi blekautin (prerje dritash për pak kohë) pas njëqinde e pesëdhjetë vjetësh.Një tërmet politike i furishem tundi parlamentin e qeverinë e këtijë vendi. Ndërsa këtu parade premtimesh. Ç'far tiu themi ne fëmijëve kur në këtë të nxehtë korriku na kërkojnë ujë të ftohtë, nga frigoriferi i cili ngrinë e shkrinë sipas orareve tepër të cunguara të energjisë me rracione të kufizuara në maximum?

Po intelektualit që përpiqet të kryej një studim apo të bëjë një publikim, ndërsa kompiuteri i tijë, tashmë një mjet i zakonshëm si dikur në shekujt e kaluar lapsi e fletoria, nuk i funsionon e i ndërpret frymëzimin e zellin për punë në kulmin e sforcimeve të trurit me një lëvizje të çelsit në kabinat elektrike?

Sot në shekullin e elektronikës ku energjia përdoret që nga komunikimi i zakoshëm e deri te analizat e ADN per arkeologët për të përcaktuar moshën e fosileve, në spitale për tiu shërbyer të sëmurëve, në industrinë mekanike e fushën e ndërtimeve, në ekonominë shtëpiake, në të gjitha qelizat e veprimtarisë njerëzore.Ndërsa slloganet partiake e qeveritare bluajne si një mulli pa kokrra për zgjidhjen e këtije problemi. Një popull i tërë ka rënë në prehërin e errësirës një economi e paralizuar bashkë me trurin e investimet e huaja.Mënyra e jetesës te shpellave është ulur këmbëkryq në truallin e këtije vendi që të ghithë e quajnë mëmëdheu i Shqiponjave.

E fiksuar në tavanin e dhomave, në muret e koridoreve, në shtyllat e neoneve të bulevardeve e ato të lulishteve, llampa kjo shpikje e shkenctarit Amerikan Tomas Edison, është e pa dobisme. Pa funkson. Në këtë vend ajo mallkon vitin 1897 kur lindi. Ndodhet në vendin e paradokseve. Ato ankohen për këtë fakeqsi të tmerrshme.

Esi mund të kthehemi?

Largohemi nga ky vend ne bashkë me investitorin, italian, gjerman, francez, kanadez, anglez duke magazinuar në trurin tonë këto pamje peisazhistike trishtuese, pesimiste, këtë udhëkryq statik të mjerueshëm . Në temat e bisedimeve të bashkëatdhetarëve të mijë, tashmë është rajvizuar shprehja:

Esi mund të kthehemi në atdheun tone? Kur vallë në këtë kënd të Adriatikut do të duken vegime shpresëdhënse të zhvillimit kompleks ekonomiko-kulturor ku prometori i të cilave është e vetmia: energjia eletrike?

Kur pisha, kandili, qiriu do ti hapin rrugë dritës llamburitëse të llampave eletrike, që të shkruajm më me qartësi, që të lehtësojmë punën e minatorit, të bujkut, të muratorit, të shkencëtarit e të zonjës së shtëpisë ? Vështroi llampat e pa jetë dhe hyjë në mendime të pafundme. E më kujtohet vetëtimëthi shprehja : Ku është bota e ku jemi ne. Shumë larg, shumë larg na ndanë errësira .

Firence 25.09.2007

LAJMËRIM

Në kujtim të 32 dibranëve të zhdukur në ujërat e Otrantos në natën e 9 marsit 1996, po përgatitet një një libër. Ftojmë të gjithë familjarët, të afërmit dhe të tjerë që kanë dijeni për këtë ngjarje të përcjellin në adresën e gazetës "Rruga e Arbrit", fotografi, shënime për jetën e personave, dokumente, kujtime, etj. Le të jetë ky libër një lapidar për ta.

Adresa: "Botimet "m&b", Rr. "Zenel Baboçi", Pall. "Ferar", Tiranë. (Për gazetën "Rruga e Arbërit") .
E-mail: **rrugaearberit@gmail.com**

Fjalë mirënjohje për Prefektin e Dibrës

Nga: **SHAQIR SKARRA**

Umbushën plot tre vjet nga dita kur Prefekti i Qarkut të Dibrës zoti Xhafer Seiti zbriti për herë të parë në qytetin e bukur të Peshkopisë.

Tre vjet nuk i thonë pak të drejtosh një prefekturë me një shtrirje mjaft të madhe gjeografike, me probleme nga më të ndryshmet.

E Xhaferi pas kaq vitesh është i bindur se ia doli mbanë. Për këtë nuk flet vetë, flet puna që ka bërë në krye të prefekturës së Qarkut të Dibrës për tre vite me radhë. Në fillim nuk e pati të lehtë, shkelte në një zonë që pak njohuri kishte, por Xhafer Seiti kishte njohuri në ligjëshmëri dhe këtu nuk shkeli asnjëherë në dërrasë të kalbur.

Xhaferi e dinte fare mirë sedrën e sëmurë dhe maninë e dibranëve se "ja përsëri nga jabanxhinjtë do të qeverisemi". Me punë dhe sjellje korrekte ndaj qytetarëve që kur zbriti në këtë qytet të vogël lindor ia hoqi vetes nocionin "jabanxhiu" pasi u shkri dhe u bë njësh me hallet dhe shqetësimet e qytetarëve dhe pse ato ishin të shumta. E kanë parë të gjithë tek ngjitej në Kala të Dodës dhe Lurë, në Ulzë e Xibër, në Selishtë e Bulqizë, në Gurë të Bardhë e Gollobordë. Ishte kjo që askush në Peshkopi, Bulqizë dhe Burrel Prefektit Xhafer Seiti të mos i thonin më "jabanxhiu", fundja dibranët e kanë patur traditë të bukur që jabanxhinjtë i kanë respektuar gjithmonë. Xhaferi bëri përjashtim pasi ua imponoi të gjithëve këtë respekt me punë dhe vetëm me punë. Intelektual i kompletuar e kuodro me përvojë të gjatë, e dinte mirë se drejtimi i pushtetit lokal nuk ishte i lehtë pasi problemet ishin nga më të ndryshme e përplasjes me qytetarët për zgjidhjen e këtyre problemeve nuk mund t'ju largohesh.

Angazhimi kryesor i tij që ditën e parë që u fut në zyrën e Prefektit të Qarkut Dibër ishte, të kthehej në çdo moment në shërbëtor të ligjit. E këtë angazhim të tij për t'u bërë garant në zbatimin e ligjeve pa i cënuar ato e ka kërkuar njëkohësisht edhe nga vetë administrata e prefekturës.

-Për të punuar mirë dhe me përkushtim, do të shprehet vetë Xhaferi, në radhë të parë duhet të njohësh gjendjen aktuale.

E që ditët e para Prefekti doli nga zyra dhe filloj inspektimin për herë të parë në teren, me qëllim që të njihej mirë me problemet emergjente .

E kush ishte ai Prefekt në Dibër që pas viteve nëntëdhjet të shkelte më këmbë të gjithë projektin e "Rrugës së Arbërit"?. Xhafer Seiti e shkeli vetë dhe jo vetëm kaq por u bashkua me intelektualët dibranë që ky projekt të realizohej në mënyrë të shpejtë si e vetmja rrugë që sillte zhvillim jo vetëm për Dibrën por edhe për Matin, Kukësin, Bulqizën dhe shqiptarët në Maqedoni.

Në fillim Prefekti filloi komunikimin me korespondencë të vazhdueshme me qeverinë lidhur me këtë projekt por më vonë në takime me qeveritarët e shtroi si domosdoshmëri ndërtimin e kësaj rruge si i vetmi koridor lindje-perëndim .

Por ky ishte një projekt afatgjatë, Dibra dhe dibranët kishin nevojë për projekte afat shkurtëra që ishin dhe më emergjente. E Xhafer Seiti u njoh shpejt me këto prebleme, dhe pse këto ishin të mbartura vite me radhë. U ul për ditë me radhë në minierën e Bulqizës mes minatorëve por shkoi edhe në Krastë të Martaneshit, qëndroi mes blegtorëve të Kalasë së Dodës , shkoj dhe tek fermerët e Shumbatit e Kastriotit, priste qytetarët në zyrë por merrte pjesë dhe në aktivitete të ndryshme që zhvilloheshin në qytetet e Peshkopisë, Bulqizës e Burrelit. Shqetësimi i qytetarëve u bë dhe shqetësim i tij. E pa si të domosdoshme që në qytetin e Peshkopisë të ngrihej një fakultet, dhe për këtë i shkroi dhe ministrit të arsimit.

-Dibranët janë arsimdashës dhe ju takon një filial i shkollës së lartë, nuk është se po ua bëjmë nder por ju takon me meritë. Ato inteligjencën e kanë dhuratë nga natyra.

Kështu do të shprehej Xhaferi në kërkesën zyrtare të tij. E prefekti i Qarkut të Dibrës nuk qëndroi me kaq.

Shqetësimet e banorëve në rajonin e Dibrës, janë bërë të njohura për Prefektin, jo vetëm në takimet javore të planifikuara për pritjen e tyre çdo ditë të martë, por në mënyrë periodike, pa i penguar ata të bëjnë takim dhe në ditët që nuk janë caktuar si ditë pritje. Më shumë informacion është marrë edhe në mbledhjet me këshillat e komunave apo bashkive. Prefekti i Qarkut të Dibrës zoti Xhafer Seiti e ka quajtur si domsdoshmëri për të gjithë zonën por dhe për vendin zhvillimin e turizmit malor në Lurë dhe me shkresa të veçanta të argumentuara u është drejtuar instancave qeveritare mbi nevojën e nisjes së investimeve konkrete në këtë trevë. Planet e zhvillimit të turizmit malor, ngritja e fermave me drurë frutore dhe ato blegtorale, punishte për përpunimin e bulmetrave, vënja në mënyrë efikase e minierave të kromit, infrastruktura dhe arsimi, shëndertsia dhe kultura, sportet e alpinizmi. Të gjitha këto kanë qënë dhe mbeten shqetësim për Xhaferin. Disa janë realizuar gjatë periudhës tre vjeçare e disa si projekte afat gjata që janë, Prefekti shpreh bindjen se do të realizohen. Nesër do të largohet ne Peshkopia Prefekti Xhafer Seiti, por dibranët do ta kujtojnë gjatë si një njeri kurajoz, kuadër me përvojë ,intelektual i kompletuar dhe shumë njerëzorë. Të tillë njerëz lënë gjurmë për vite me radhë dhe për këto ka nevojë shoqëria jonë.

fejton

Ramiz Gjini sjell posaçërisht për gazetën një fejton, gjini të harruar nga gazetaria e shkruar shqiptare dhe, problematika e fejtonit është pikërisht për gazetarët, që sipas Xha Hasanit, "janë ba kaps".

Xha Hasani dhe kapsllëku intelektual i gazetarëve

Nga: **Ramiz GJINI**

Pranë shtëpisë time, banon një plak i moshuar, i cili quhet Hasan.

Xha Hasani, ngase nuk kishte mundur të bënte asnjë klasë shkollë, nuk di shkrim e këndim. Mirëpo, ai ka një kureshtje manjaku për të dëgjuar e kuptuar çfarë ndodh në politikën shqiptare.

Çdo ditë, xha Hasani, blen pothuaj të gjitha gazetat dhe vjen tek unë për t'ia lexuar.

Lajmet me vdekje aksidentale, vetvrasjet e sidomos vrasjet, shkurt fjala, kronika e zezë, e mërzit xha Hasanin, ndaj gjithmonë, ia kaloj shpejt e shpejt duke i lexuar vetëm titujt. Ama, kur është fjala për analizat që bëjnë gazetarët tanë të njohur, nuk do që t'i shpëtojë asnjë fjalë pa i hyrë në vesh. Njeh si emër Selim Belortajën, Andi Bejtën, Aleksandër Çipën, Frrok Çupin, Ilir Dhimën, Kastriot Myftarajn, Andrea Stefanin, Mentor Nazarkon, Fatos Baxhakun, Rudina Xhungën, Alba Maltezin, Kiço Blushin, Bashkim Koplikun, e sidomos, Mustafa Nanon. Pra, xha Hasani, njeh pothuajse gjithë përfaqësuesit e *zërit të së vërtetës* në Shqipëri.

Mustafain e pati dashur aq shumë në fillim, sa po të kishte mundësi, do ta kishte bërë djalë në shpirt. I kishte mbetur në mendje një pasazh, me të cilin Muçi, pati nisur një analizë. Nga shkonte, xha Hasani mërmëriste me vete pasazhin e asaj analize: *" Një idjot me emrin Gerti Bogdani, (unë nuk kam njohur në jetën time njeri më idjot se ky), lexoi një deklaratë të hartuar nga një i çmendur me emrin Sali Berisha,(unë nuk kamë njohur në jetën time njeri më të çmendur se ky)..."*

- Ky Muçi, ose asht' shkollu për idjotizëm dhe çmenduri, - tha xha Hasani, - ose ka ndejtë gjatë me idjotët dhe të çmendurit, ndryshe nuk ka mundësi të jetë kaq i zoti sa të rendisë në shkrim konkluzionet para fakteve.

Veç shkrimeve analitike, aso kohe, xha Hasani preferonte shumë t'i lexoja materiale në rubrikën: "*Ju pyesni, Mustafa Nano përgjigjet*". Këmbëngulte të nisja me e-mail në adresë të Mustafait shumë pyetje, pasi besonte që përgjigjet e Muçit, do t'i zbardhnin ca interesa vetiake. Përshembull, xha Hasani nuk dinte të vendoste, a ta bënte tramkë gomarin me një dhi duke marrë si kompensim edhe një torbë me tërshërë, apo t'i kërkonte tjetrit lekë në vend të tërshërës? Ja, për këtë donte të pyeste Mustafa Nanon! Pyetja tjetër ishte: a do të binte shi në Shijak pasnesër në orët e vona të natës? Kishte merak plaku, sepse i biri i tij, Zeqiri, që jetonte në një fshat pranë Shijakut, donte të varte jashtë ca duhan për t'u tharë dhe kishte frik se mos ia lagte shiu. Një herë tjetër, më tha t'i nisja Muçit një pyetje pasi donte të dinte egzakt sa larg ishte Toka nga planeti Neptun. "

- Tani e teprove, xha Hasan, - i thashë, - Muçi nuk merr vesh nga astronomia.

- Shkruaj, mor çun, aty? - mu hakërrye, - " sepse s'ka gja, që Muçi se di".

Aq besim të madh kishte tek Mustafai, sa edhe pse nuk dinte të lexonte, i vështronte artikujt e tij me orë të tëra, që t'u a nxirrte kuptimin pa i lexuar.

Një fundjave, (ka qenë e shtunë, më duket), xha Hasani erdhi e më thirri që nga oborri. Dola jashtë dhe si e përshëndeta, e ftova të hynte brenda, por nuk pranoi. Atëherë zumë vend në oborr, dhe ai, si drodhi njëherë mustaqet me majë të gishtave, fët e fët, nxorri nga xhepi dy fotografi. Njëra qe e Selim Belortajës, kurse tjetra e Bashkim Koplikut. I kishte prerë nga gazetat dhe donte t'i zmadhonte për t'i varur në murin e odës së miqve. Tha se i pëlqenin ato lloj gazetarësh, që në shkrimet e tyre, analizonin Berishën dhe jo problemet që ka vendi. "

- Selimin dhe Bashkimin, i kam fort qejf, sepse ia kanë ba *gërdec* Berishës me do analiza, - tha xha Hasani.

Dy ditë më parë, kishte pas varur në murin e odës së burrave portretin e analistit Andrea Stefani, por e kishte zhvarur pas asaj analizës me titull të përzier me fjalë në gjuhë të huaj,"**Win-win apo win-twin**", që shkruajti Andrea i shqetësuar për rritjen e çmimit të lulelakrës në Shqipëri.

Xha Hasani tha se titullin nuk e kishte honepsur, pasi qe në një gjuhë, që ai se merrte vesh. Kurse shkrimin në përgjithësi, si të thuash, nuk e pati honepsur sepse.., sepse... Troç muhabeti, Xha Hasani se hante lulelakrën, ndaj dhe se kishte parë me interes atë shkrim. Të paktën, nuk e hante aq sa Andrea.

Duhet thënë, që xha Hasani ishte fort i ndjeshëm karshi titujve të shkrimeve në gazeta. Thoshte, që spërkatja që u bëjnë disa gazetarë titujve dhe shkrimeve me fjalë të huaja, i frynte barkun. Dhe barku i fryrë, kur të tradhëton me ndonjë krismë ilegale mes njerëzve, të turpëron. Kurse figurat letrare, e qorrollepsnin dhe e hutonin xha Hasanin, nuk arrinte dot t'u a rrokte kuptimin, sado që e vriste rradaken. Përshembull, një ditë kur desha t'i lexoja një shkrim të titulluar "**Shqipëria kalon lumin**" të një gazetareje me shkollë të lartë, që emri tani nuk po më kjtohet, xha Hasani, u dëshpërua fort, pasi nuk e imagjinonte dot Shqipërinë matanë lumit. Por kur i shpjegova, që shkrimi bënte fjalë për ca ushqime të skaduara, që ishin magazinuar, si të thuash, këtej lumit, atëherë ai u qetësua. Tha se mirë kishte bërë Shqipëria, që e kishte kaluar lumin. Por ai shtoi, që duhej bërë kujdes, sepse larg qoftë, mund të ndodhte që Shqipëria, të kthehej sërish këtej lumit, pranë ushqimeve të skaduara dhe pastaj... Lëre, lëre se ç'hata e madhe do të ishte!

- Sido që të jetë, xha Hasan, sado që t'i duash Selimin dhe Bashkimin, - i thashë unë, - nuk mendoj se ia vlen, që portretet e tyre t'i vendosësh në murin e dhomës së miqve. Atëherë plaku u mëdysh, i fryu njëherë çibukut, dhe si filloi ta mbushte me duhan pyeti:

- Po sikur të vendosja Kastriot Myftarajn? - Para do kohësh, ai djalë, ka krrellë do artikuj, aq të hollë sa ene Kristaqin, e bani Ahmet.

- Si e bëri Kristaqin Ahmet? - e pyeta përnjëherësh unë.

- Po me fjalë, mor çun, e bani, me fjalë ta kisha llafin! Oj, ky! - u nxeh xha Hasani.

Më vonë, gjatë bisedave që pata me të, do të kuptoja, që xha Hasani, e kishte marrë gazetarinë si një kategori muhabeti, gjë, e cila, siç e dimë të gjithë ne lezuesit, nuk është aspak e vërtetë. Ai kishte nxjerrë konkluzionin, që gazetarët tanë, na qenkan llafazanët më të mëdhenj, ndaj dhe nuk i pëlqente. Atëherë e kundërshtova, por me takt, sepse xha Hasanit, po t'i hypin rrebet, nuk ta përton fort. Ta fut njëherë me shkop kaptinës, pastaj nxjerr e të vendos duhan mbi plagë. Kështu, i fola pak a shumë mbi rolin e gazetarisë në Shqipëri, ku i shpjegova, që misioni i gazetarëve, ishte të identifikonin shkaqet që sjellin probleme në një shoqëri me autoritet shtetëror, dhe në rastin më të mirë, të jepnin edhe zgjidhje, dhe jo të bënin politikë me muhabete kundër njërit apo tjetrit shtetarë për interesa meskine. Dhe gazetarët tanë, pikërisht gjënë më të drejtë po bëjnë. Ata thjeshtë zbulojnë problemet, gjejnë shkaqet dhe ndihmojnë duke dhënë zgjidhje.

Me të drejtë gazetarja Alba Maltezi, në një shkrim të saj, pyet: "A nuk qenë gazetarët ata, që e shpëtuan rërën e plazhit të Vlorës, që deshën të na e merrnin italianët"? Pra, nëse nuk do të kishim gazetarët, padyshim që italianët, do na kishin marrë, jo vetëm rërën e plazhit të Vlorës, por edhe dheun e kodrave të Saukut, argjilat e Zalldushkut, gurët e malit të Dajtit, madje rrezik se do na kishin marrë edhe të gjitha gropat e Malit me gropa.

Dy ditë kishte, që nisi një far debati mbi rolin e gazetarisë dhe xha Hasani, ia behu sërish tek unë e gjithë siguri, tha:

- Ti, or çun, e do shkopin kresë.

- Përse, xha Hasan, - pyeta une, ndërsa u tuta nga frika.

- A të kisha thanë që gazetaria në këtë nahijen tonë bahet veç me llafe n'erë? Bile gazetaria tek ne asht' një muhabet, ngul e shkul n'byth të njani-tjetrit. Nuk dua të më lexosh ma asnji shkrim të tyne. Sak ma, nuk dua. Dhe, a e di pse? Ta thotë xha Hasani ty: janë ba kaps. Kaps, thashë, a merr vesh? Vetëm shtërzime kanë. E nga shtërzimet, ti e di mirë, or çun, çfarë del. Për çfarë na janë mbledhë e bajnë debat si ke Ferra e Pashës ato?

- Po për rolin e gazetarisë, mor xha Hasan, - i thashë përnjëherësh unë si të desha të shfajsohesha.

- Po, a kan ba shkollë gazetarie ata, mor çun? - u nxeh ai. - A kan knue libra për gazetarinë, ata? A e kan msue zanatin para se t'ia hynin k'saj pune?

- Ehë, - ia bëra unë, - edhe libra kanë lexuar, edhe shkollë gazetarie kanë bërë; kanë marrë leksione nga profesorë me emër ku kanë mësuar, çfarë roli ka gazetaria.

- Po atëherë, pse bajnë debat për rolin e gazetarisë ata, kur na e paskan m'sue zanatin qysh n'banga t'shkollës?

Çfarë t'i thoja xha Hasanit?

U përpoqa ta qetësoja duke i zgjatur një cigare, por ai as cigaren se mori.

Iku i inatosur, ndërsa mërmëriste me vete:

- Janë ba kaps, or çun, ta dish... Po, po, janë ba kaps, vallahi...

KENGA BURIMORE

Zhvillohet festivali i parë i Këngës Burimore Lirike në Burrel

Dy ditë qyteti i Burrelit pati për vizitorë këngëtarë nga poullorë lirikë nga dy qarqe të vendit, Dibrës dhe Lezhës. Ngjyrat e shumta të kostumeve tona popullore, tingujt e ëmbël të orkestrinave dhe bisedat e ngrohta mes artistëve e banorëve, dhanë gjallëri cep e në cep të qytetit. Ishte Festivali i Parë Folklorik i Këngës Burimore Lirike, që u zhvillua më 9-10 tetor 2008.

Përshendeti Festivalin zv/ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit z.Ekrem Spahia, i cili vlerësoi aktivitetin, si dhe Festivalet tjera tipologjike që ka zhvilluar Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folkorike në bashkëpunim me bashkitë dhe qarqet e vendit. Gjatë këtij viti, tha ai, QKVF ka marrë masa serioze shkencore dhe organizative, publikuese e kontrolluese në mënyrë që këto tipologji të vlerave shpirtërore të identitetit tonë kombëtar të zhvillohen sa më denjësisht dhe orgjinalitet.

Festivali i Birrelit ishte edicioni i parë i një veprimtarie të tillë. Tashmë është përfituar një përvojë e mjaftueshme që Burreli të bëhet vendi ku do të zhvillohet i përvitshëm Festivali i Këngës Lirike Burimore, duke shtuar grupet pjesëmarrëse nga gjithë vendi.



Bashkëpunimi i mirë i punës me Bashkinë e Burrelit, për të cilën vlerësojmë punën e stafit drejtues, si dhe me Qendrat Kulturore të rretheve, realizoi cilësisht një festival i suksesshëm, festival i cili tregoi se Kënga Lirike si pjesë e trashëgimisë kulturore të popullit tonë, ka mbetur e pastër, me plot vlera estetike dhe të interpretuar me origjinalitet nga këngëtarët popullorë. Festivali ishte në parametrat e duhur artistikë dhe u ndoq nga qindra spektatorë. Juria e përbërë nga Izet Duraku, Sabrie Nushi dhe Edmond Zaçeliqi, vlerësoi në vendin e parë grupin e Matit, në të dytin e të tretin Kurbini dhe Mirdita. Gjithashtu u ndanë dipoloma për këngëtarët dhe këngëtaret më të mira.

Dita e dytë e veprimtarisë iu kushtua Orkestrinës Popullore të Matit, e cila mbushi 40 vjetët e krijimit të saj. Në fillim u dha koncert me numra të zgjedhur dhe pas tij dokumentari televiziv kushtuar veprimtarive të Orkestrinës Popullore të Matit. Në mes të këtyre dy shfaqjeve në skenë u ngjitën themelues të kësaj orkestrine si Ymer Nelaj, Xhevat Lishi, Sabri Aliaj e të tjerë, si dhe këngëtare të njohura si Feride Kurti me shoqe, duke u plotësuar më së miri me praninë në sallë të Lirie Rashës. Feride Kurti dhe Lirie Rasha për dëshirën e spektatorit këndu-an këngët e tyre të dikurshme, duke ngritur në këmbë publikun e pranishëm. Ishin momente gëzimi të përziera me lot, pasi mosha kish bërë punën e vet. Ata që dikur dridheshin në tingujt e veglave popullore muzikore, ata që zëri i tyre dilte si zë bilbili, tashmë vendin e tyre e kishin zënë të tjerë artisë. Megjithatë, Ymer Nelaj, edhe pse mbi të shtatëdhjetat, nuk dorëzohej. Ai kishte një grup të rinjësh me vegla popullore, që tregonin se nga puna këmbëngulse e tij, do dilnin me dhjetra artistë si Ymeri. Emocione ngjalli dairja në një çast të vetëm në dorët e Xhevat Lishit, kur ai ngriti në këmbë sallën me atë mjeshtrinë e tij madhe në interpretim. Në radhë u shpëndanë "Mirënjhje" për artistët matjanë dhe të qarqeve Dibër e Lezhë. Të parit i takoi Hilmi Kolgjegjës (pas vdekjes), me motivacionin **"**Për kontribut të shquar në folklorin dibran", pastaj muzikantit Mynir Shehut (pas vdekjes), "Krijues i shquar në muzikën popullore"; Sabri Aliut, "Krijues i këngës matjane; Qamil Beshkut –"Instrumentist i shquar në Lauri"; Hajrulla Cenit –"Rapsod i shquar në Lauri; Agim Velajt, "Drejtues i Ansamblit "Çiftelia", Lezhë"; Xhelal Çerpjes, "I shquar në veprimtaritë folklorike të Zall-Dardhës; Liri Rashës, "E shquar në Këngën Lirike Popullore"; Mark Gjokës, "Krijues i shquar i Këngës Popullore Mirditore", si dhe Orkestrinës së Matit – "Për vlera të shquara instrumentale".

Dokumentari televiziv ishte një tjetër risi e sjellë në veprimtari të tilla. Aty ishin vlerat e një orkestre, të disa artistëve ndër vite, që kishin shkrirë shpirtin e tyre për artin popullor. Stafit drejtues të QKVF, drejtorit të saj z.Esat Ruka ui drejtuan falenderimet më të mira nga gjithë të pranishmit për punën e bërë. Falenderime pati edhe Bashkia Burrel, Qendra Kulturore dhe artistët matjanë që ndihmuan në ketë aktivitet që tani hyri në kalendar të përmasave kombëtare.

Sh.Skara

Rruga Arbërit nr. 30
kronikë

Shoqata e Ish të Burgosurve dhe të Dëmtuarve Politikë Shqiptarë, në Dibër të Madhe u bën thirrje partive politike për më shumë përmbajtje dhe angazhim më të madh për një politikë të drejtë dhe mospërçarëse

Shoqata e Ish të Burgosurve dhe të Dëmtuarve Politikë Shqiptarë në Maqedoni bën apel:

"Partitë shqiptare të mos flasin në emër të popullit"

Shoqata e Ish të Burgosurve dhe të Dëmtuarve Politikë Shqiptarë, në Dibër të Madhe, mbajti para pak kohësh një konferencë me përfaqësuesit e mediave.

Shpëtim Pollozhani, kryetar kësaj shoqate, deklaroi: "Si rezultat takimeve që kemi patur nëpër nëndet dhe si rezultat vendimit të Kryesisë Qëndrore të shoqatës sonë, vendosëm që këtu në Dibër të Madhe, në qytetin e kuvendeve, në qytetin me histori më të pasur se të gjitha qytetet tjera shqiptare të këyre anëve, sot ta informojmë opinionin për aktivitetet tona të mëtutjeshme. Duke marë parasysh faktet se në skenën politike shqiptare janë duke u zhvilluar procese regresive, ne ftojmë opinionin të krijojë një vetëdije të shëndoshë politike dhe të largohet nga praktika e deritashme 19 vjeçare, e cila është impotente e shterpë, dhe të ndërojë metodologjinë e veprimtarisë së vet politike. Duke marë parasysh se shumë ligje, shumë situata janë anakronike, degraduese për ne shqiptarët, mendojmë se partitë politike shqiptare nuk kanë legjitimitet të flasin në emër të popullit shqiptar, por të flasin vetëm në emër të votuesve të vet, votues për të cilët edhe pse kanë njëfarë legalitetit, nuk kanë legjitimitet , pasi edhe ato vota janë të dyshimta".



Duke numruar gabimet e partive politike shqiptare në Maqedoni, Pollozhani, theksoi se: "Tetë muajt e fundit ndodhën raste me të vërtetë eklatante, ku shqiptarët sjellen në një pozitë shumë përbuzëse dhe denigruese. Kemi njëfarë Marrëveshje të Marsit, pastaj njëfarë Marrëveshje të Majit, pastaj kemi shkeljen e dy marrëveshjeve dhe kemi bërë zgjedhjet, pastaj kemi një Ligj për flamur, i cili me të vërtetë është poshtërues dhe me këtë ligj një shqiptar i cili përdor flamurin shqiptar, simbolin kombëtar shqiptar, duke mos e përdorur atë të shtetit, ai dënohet me burg. Kemi gjithashtu një ligj tjetër denigrues, Ligjin për përdorimin e himnit, ku një shqiptar në Maqedoni dënohet nëse e këndon himnin shqiptar para atij të shtetit. Rasti tjetër denigrues është Ligji për natalitetin, ku përfshihet stimulim nga ana e shtetit për zonat ku nataliteti është nën 2,5 promila. Rasti tjetër është mënyra e zgjedhjes së kryetarit të shtetit. Pastaj është rasti i luajtjes majtap me deputetët tanë, që duhet të jetë turp për partitë shqiptare. Këta deputetë kanë imunitet, kanë elektorat dhe dikush luan edhe me elektoratin edhe me munitetin e tyre. Kemi edhe një rast tjetër me të vërtetë të pakrahasueshëm, kur kryetari i parlamentit para opinionit dhe përfaqësuesit të bashkësisë ndërkombëtare, deklaron se, "me të vërtetë kemi sjellë shumë ligje që nuk është dashtë t'i sjellim, kemi shkelur procedura që nuk është dashtë t'i shkelim, por tash e tutje nuk do të punojmë kështu".

Qëllimi i shoqatës sonë, u shpreh Pollozhani, nuk është që, "në këtë situatë të bëjmë vlerësime ose kritika politike, por ta ftojmë opinionin e gjerë shqiptar, këtë forcë të dytë për nga potenciali ekonomik dhe politik, që të esëllohet e të gjejë rrugën e vërtetë. Rruga e vërtetë në këtë situatë është marrja e legjitimitetit të partive politike dhe kërkesa që ato të mos flasin më në emër të popullit shqiptar, por të flasin vetëm në emër të partive të veta. Dhe e dyta apelojmë te të gjitha shoqatat, asociacionet, individët, institutet dhe institucionet, që në mënyrë individuale ose kolektive të krijojnë vetëdije dhe disponim politik për të krijuar një lëvizje qytetare. Në Maqedoni ka 1800 OJQ, pesha dhe fjala e tyre peshojnë, vetën nëse nuk kontrollohen nga shteti.

E shifni se çfarë lufte po bën shoqata e jonë për zhdëmtimin e ish të burgosurve politikë, e sollëm deridiku çështjen, tani çdo gjë u kthye prapë dhe çdo gjë fillon nga fllimi.

Dibra e Madhe do të jetë zëdhënëse dhe nismëtare e një lëvizje qytetare ku do të grumbullohen intelektualë, individë, grupe dhe grupacione të ndryshme për ta marë fatin tonë në duart tona. Ky qëndrim i shoqatës ka ardhur si rezultat i shumë konsultimeve me intelektualë, me individë. Ka shumë kërkesa për formimin e një subjekti të ri politik, por kjo do të ishte tradhëti ndaj shoqatës dhe ndaj idealeve tona. Kemi patur oferta edhe nga partitë e tjera politike, por ne do të përmbajmë çdo individ apo lëvizje që do t'i bashkojë shqiptarët e jo që do t'i ndajë. Sepse potenciali ynë politik tash ka arritur nivelin zero".

Bashkim Bashkulli, nënkryetar i Shoqatës dhe dhe kryetar i Degës së kësaj shoqate në Dibër të Madhe, foli për zvarritjen që bën Maqedonia për njohjen e Shtetit të Kosovës, duke thënë se: "Qeveria e Maqedonisë po tallet me shqiptarët e Maqedonisë, të cilët për pavarësinë e Kosovës dhanë kontribut të madh. Tani Qeveria e Maqedonisë i injoron shqiptarët, bile edhe tallet me datat. Partitë tona politike që ne i shpallim jolegjitime, japin data të ndryshme e të kota. Ato nuk janë si partnere në qeveri, por janë vetëm si dekor.

Nga ky vend u bëjmë thirrje shqiptarëve që të organizohen vetë nëpërmjet protestave e mënyrave tjera demokratike që Maqedonia ta njohë Kosovën".

R.TORTE

Shkruajnë lexuesit

Te nderuar pjestare te redaksise se gazetes "Rruga e Arberit":

Jam nje lexues i rregullt i gazetes nga SHBA. Me nje kenaqesi te vecante lexova ne faqet e gazetes tuaj ne internet, nje artikull per nje nga patriotet e shquar te Dibres e mbare Shqiperise, Elez Sadik Koçi.

Une quhem Atmir Kurti dhe se bashku me vellezerit e mi Agron e Xhemal Kurti, rrjedh nga familja e Elez Kocit; une jam i biri i Faik Xhemal Kurtit, i biri i Rakibe Kocit, e bija e Elez Kocit. Nuk mund t'ju pershkruaj kenaqesine e madhe qe ndiej kur lexoj per nismat e shquara tuaja per te nderuar personalitetet qe ka nxjerre Dibra legjendare.

Babai im i ndjere, Faik Kurti, ka punuar per vite me rradhe ne Ansamblin e Shtetit dhe Ansamblin e Ushtrise si valltar profesionist se bashku me mjeshtra te valles popullore si Besim Zekthi, Panajot Kanaci, Gezim Kaceli, Lili Cingu, etj. Me vone ka dhene mesim dhe si pedagog ne Shkollen e Baletit e Shtepi Pioneri te ndryshme.

Disponoj ne arkiven personale te familjes, foto te ndryshme nga aktiviteti i tij, me vlera etnografike per veshjet nga krahina e Dibres dhe nje foto te valles se Peshkopise me solist valletarin e shquar Besim Zekthi. Gjithashtu dhe nje foto origjinale te rralle te Ansamblit te Shtetit me trupen e pare.

Me kenaqesi ia ve ne dispozicion, Stafit tuaj, kopje te ketij arkivi te cilat mund t'ju hyne ne pune ne numrat e ardhshem e gazetes.

Duke ju uruar suksese dhe falenderuar per publikim e gazetes ne internet, ju pershendes nga Arizona, USA.

Me respekt,
Atmir Faik Kurti.



Uji i Radikës për vaditjen e tokës

Në këtë takim u prezantuan kuotat dhe traseja e ndërtimit të kanalit ujitës nga lumi Radikë me rënie të lirë të ujit në gjatësi prej 20 kilometra. Ndërtimi i këtij kanali për ujitje do të mundësojë ujitjen e 4000 mijë hektarëve tokë bujqësore në Dibër të Madhe dhe 1000 hektarëve në komunën e Maqellarës në Shqipëri.

Në Dibër të Madhe, më date 16 tetor 2008, u takuan udhëheqës dhe ekpertë të ministrive të Bujqësisë të Maqedonisë dhe Shqipërisë që meren me ekonominë e ujërave.

Në këtë takim nga Maqedonia merrnin pjesë Sllave Arsovski-Drejtor i Drejtorisë për ekonominë e ujërave, Bllagoja Stoilkov, këshilltar shtetëror në ekonominë e ujërave, Bobi Nofitovski,këshilltar shtetëror për politikën bujqësore, Goce Llazarovski, ekspert,Zoran Stojçevski përfaqësues i ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Vesel Duka , kryeshef në njësinë rajonale të Bujqësisë, Nizamedin Papraniku, kryesues I KK, Ylli Mirzo dhe Reshat Qormemeti, përfaqësues të pushtetit vendor dhe Dr. Abdyl Koleci, kryetar I Shoqatës së bujqve dibranë "Fusha e Dibrës" nga Dibra e Madhe.

Nga Shqipëria merrnin pjesë Irfan Tarelli, Drejtor I përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë së Shqipërisë, Esat Hasani, drejtor I menaxhimit të tokës bujqësore dhe ujërave, Maksim Hajrullai dhe Ferit Hoxha,nga Drejtoria rajonale e bujqësisë dhe e kullimit të ujërave Peshkopi.

Siç u tha këtu, ky takim është rezultat I nismës nga Dibra e Madhe për ndërtimin e një kanali nga lumi Radikë për ujitjen e tokave në Dibër të Madhe në Maqedoni dhe në komunën e Maqellarës në Shqipëri, nismë të cilën fillimisht e kanë mbështetur Argëtim Fida, kryetar I komunës Dibra e Madhe dhe homologu I tij Ilir Krosi, kryetar I Bashkisë së Peshkopisë. Kjo nismë u miratua edhe nga Këshilli I Komunës në Dibër të Madhe. Pas një lobimi intensiv të kryetarëve Argëtim Fida dhe Ilir Krosi, kjo ide u mbështet edhe nga Ace Spasenovki, ministër I Bujqësisë I Maqedonisë dhe Jemin Gjana, ministër I Bujësisë nga Shqipëria.

Në këtë takim inxh. Rexhep Qormemeti, autor i kësaj projektideje, prezentoi hartën, kuotat dhe trasenë e ndërtimit të kanalit ujitës nga lumi Radikë me rënie të lirë të ujit në gjatësi prej 20 kilometra.

Drejtorët e drejtorive të ekonomisë së ujërave dhe ekspertë të dy vendeve ranë dakord se ky projekt është me levërdi të madhe për zhvillimin e bujqësisë të dy vendeve , sidomos tani kur kërkesa për artikuj ushqimorë është në rritje dhe kur lypsen ushqime sasiore dhe cilësore.Ndërtimi I këtij kanali për ujitje do të mundësojë ujitjen e 4000 mijë hektarëve tokë bujqësore në Dibër të Madhe dhe 1000 hektarëve në komunën e Maqellarës në Shqipëri.

Në mungesë të këtij kanali për ujitje, fermerët e kësaj zone nuk kanë asfarë mundësie për mbjelljen e kulturave të nevojshme bujqësore për sigurimin e bukës së gojës, gjë që i detyron të kapin rrugën e mërgimit. Në këtë takim u diskutuan edhe aspektet teknike, kuotat prej ku do të merret uji, i cili do të shfrytëzohet për ujitje dhe për prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit edhe të një minihidrocentrali.

Në fund u ra dakord që me konkluzat e këtij takimi të njoftohen ministrat e bujqësisë së dy vendeve, të cilët do t'i propozojnë edhe takimet e ardhshme për studimin e fisibilitetit, zgjedhjen e variantit më të mirë dhe hartimin e projektit final.Te dyja palët shprehën dëshirën dhe optimizmin për mbështetjen e këtij projekti nga qeveritë e dy vendeve dhe për gjetjen e mjeteve financiare nga Banka Botërore dhe nga donatorë të tjerë, mbi bazën e bashkëpunimit ndërshtetëror dhe ndërkufitar si dy vende fqinje.

R.T.


portret

Naim Plaku shkruan: "Në këtë kohë që po flitet kaq shumë për hapjen e dosjeve, mendova t'ju dërgoi këtë shkrim për ta botuar, për një ish - oficer nga Dibra të goditur rëndë nga Diktatura dhe që mendoj se e meriton të shkruhet për të"

ALI BANA

Një dosje e bardhë që duhet hapur

Nga: **NAIM PLAKU**



Ali Bana, fotografuar pas torturave në burg

Këto ditë, ndërsa flitete e përflitet aq shumë për hapjen Dosjeve të Zeza të komunizmit...duhen hapur dhe ato Dosjet e Bardha, viktima të Dosjeve të Zeza, që kanë brenda virtytet e larta të shqiptarit, besën e burrërinë, qëndresën e trimërinë, dosjen e atyre që hoqën e vuajtën nga diktatura, dosjet e atyre që humbën jetën, rininë e talentin, dosjet e bardha të atyre që mbajnë brenda emrin e tyre të nderuar...

Janë disa figura që kujtesa njerëzore i nxjerr herë pas here në sipërfaqe, sepse kanë lënë diçka të vyer, diçka njerëzore të pashlyer, kanë patur vlera të veçanta morale e profesionale, kanë shkëlqyer me talentin e tyre në një fushë të caktuar, pra, kanë lënë një vepër të nderuar që përmendet e do të përmendet me respekt. I tillë ishte dhe Ali Bana nga fshati Pollazhan i Dibrës, një oficer i talentuar karriere, me plot merita të veçanta në fushën e artit ushtarak, që diktatura e flaku nga rradhët e ushtrisë si armik të popullit, e burgosi dhe e torturoi vite të tëra nëpër burgjet komuniste me akuzat e njohura tashmë për agjitacion e propogandë kundër pushtetit popullor, për moskallzim krimi, etj, etj,..

Po kush ishte Ali Bana? Cfarë bëri dhe pse u ndoq e u persekutua kaq egër? Përse u denigrua figura e tij si një kuadër me përvojë, si një nga oficerët më të përgatitur të ushtrisë shqiptare e me merita të veçanta në përgatitjen ushtarake? Përse u shpall armik i popullit? Cfarë agjitacioni e propogande kishte bërë ai?

Disa prej këtyre pyetjeve që parashtrojmë ne e kanë përgjigjen e tyre në vendimin e Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë të RPSSH me nr. 99, të datës 26.10.1966, që i përket të akuzuarit Ali Sali Bana dhe që akuzohet se " **Ka zhvilluar agjitacion e propogandë kundër Pushtetit Popullor, për moskallzim krimi, për shpërdorim të pozitës zyrtare, se ka ulur dinjitetin ushtarak, armëmbajtje pa leje, etj...**"

Në përfundim të këtij gjyqi farsë oficëri Ali Bana dënohet me 15 vjet burgim, me humbjen e titujve dhe gradave si oficer, me konfiskim të pasdurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale. Pas kalvarit të vuajtjeve e persekutimeve nga më të egrat për të dhe familjen e tij, pas përfundimit të dënimit, oficeri i talentuar, punon sa për të fituar bukën e gojës, por përsëri nën survejimin e organeve të sigurimit, që e trajtonin si armikun më të rrezikshëm të Pushtetit Popullor, si një ushtarak që dinte sekretet e mbrojtjes dhe i disponuar "*për t'u bërë kontigjent i armikut*", siç shpreheshin ata.

Aliu lindi më 1927 në një familje të varfër fshatare, por me tradita patriotike në mbrojtje të lirisë dhe pavarësisë së vendit. Natyra e pajisi me një zgjuarsi e zotësi të tillë, me një trup të hijshëm prej ushtaraku, me një intuitë të pazakontë për t'i rrokur e trajtuar shpejt situatat, për t'i përqafuar dhe përvetësuar sa më parë dukuritë e reja që po sillnin vitet e shekullit XX në Shqipëri.

Kishte dëshirë për t'u bërë një njeri i arsimuar dhe ia arriti ta bëjë këtë me aq sa ia lejonin kushtet e asaj kohe. Në Luftën Antifashiste u rradhit shpejt në formacionet e Brigadës 18S dhe tregoi shembuj heroizmi duke marrë pjesë aktive në të gjitha aksionet e kësaj Brigade gjer në çlirimin e plotë të vendit. Në disa beteja të ashpra që zhvilloi kjo Brigadë shquhen aftësitë dhe trimëritë e djaloshit, që e kishte marrë me kaq pasion përvetësimin e artit ushtarak dhe shikohej nga kuodrot drejtuese të asaj kohe si një oficer që premtonte për të ardhmen. Pasi trajnohet si oficer në disa kurse emergjente dhe duke pasur edhe një përgatitje të shkëlqyer fizike, merr gradën aspirant. Në dokumentin që disponon familja e tij, Ali Bana e mbaron me të gjitha notat shkëlqyeshëm këtë kurs dhe, pikërisht për këto merita, e emrojnë si instruktor në Shkollën e Bashkuar deri në vitin 1956 ku jep një ndihmesë të madhe sidomos në përgatitjen fizike të kuadrove ushtarakë të asaj kohe. Në vitin 1960 i besohet një detyrë e rëndësishme. Me urdhër të ministrit të mbrojtjes së asaj kohe, Beqir Ballukut, caktohet komandant i Batalionit mitralier në vijën e parë të kufirit verilindor të Shqipërisë me Jugosllavinë duke vepruar me guxim e trimëri në situatat e vështira që kishte regjimi i kufirit të atyre viteve. Edhe këtu Kapiteni i Parë Ali Bana u shqua si një ushtarak i devotshëm e i aftë për të marrë në dorë e për të kryer detyrat nga më të vështirat.

Më vonë ai kalon komandant i Batalionit të Fushë – Qidhnës. Ky repart ushtarak në atë kohë, ku merrej krahas stërvitjes së ushtarëve efektivë edhe me rezervistët e gjithë zonës, që përfshinte më shumë se gjysmën e rrethit të Dibrës, u kthye në një repart shembullor, në një shkollë të vërtetë ku merrnin shembull gjithë repartet e tjera të Veriut për një përgatitje të lartë ushtarake, për disiplinë shembullore, për njohjen e thellë të artit ushtarak. Tregojnë se ushtarët e Ali Banës, kështu e thirrnin efektivin që komandonte ai, zbërthenin e mbërthenin me sy mbyllur për disa sekonda të gjitha llojet e armëve që kishte në përdorim reparti. Qarkullonte një fjalë atëherë në Dibër për t'iu kundërvënë njerëzve të pa mësuar me disiplinë pune: "*Duhet të shkosh pak ditë tek Ali Bana që të mësosh*". Këto suksese i arriti duke dhënë vetë shembullin e tij personal dhe duke qenë gjithmonë i drejtë e i paanshëm, me këmbëngulje e vullnet të pashoq, me një komunikim e urtësi të admirueshme për çdo ushtarak.

Kapiteni i Parë, komandanti i këtij Batalioni në një zonë tepër të vështirë, mu në vijën e parë të kufirit me jugosllavët, e shndërroi këtë repart në një shkollë përvoje ku mësohej arti i vërtetë ushtarak popullor dhe jo siç propogandonte me të madhe vija politike e Enver Hoxhës në atë kohë dhe që zbatohej nga oficerë të paaftë e militantë të Partisë Socialiste. Si çdo kuadër që zotëronte vlera e kishte fituar popullaritet e respekt puna e tij shihej me perde të errëta dhe ngulmohej për t'i gjetur diçka e për ta mbajtur të lidhur pas këmbëve të injorancës. Kështu u veprua edhe ndaj oficerit Ali Bana. Filluan shpifjet, përndjekjet, përgjimet nga organet e Sigurimit, filloi të nxihej ajo që ishte e mirë, të gjurmohej dhe t'i gjendej ajo kleçka nga mund të përgjunjej e të thyhej karriera e tij. Kështu filloi të hartohej edhe skenari për oficerin e nderuar Ali Bana që, si çdo hero tjetër tragjik, edhe ky do të përfundonte në burgjet komuniste si armik i rrezikshëm dhe me akuzën e rëndë e të trilluar për tradhti të lartë, për bashkëpunëtor të agjenturave sërbe në Shqipëri, për shfaqje bajraktarizmi, për shkarje të qëllimshme nga vija e masave në ushtri.

Në gjyqin ushtarak dolën disa dëshmitarë të rremë dhe, që të përligjin atë që ishte menduar për këtë kuadër të merituar, nxorrën përveç atyre edhe disa dëshmi që sot për ne do të ishin qesharake, por që në atë kohë rëndonin fort në gjykimin e tij, përforconin akuzën kryesore të agjitacionit e propogandës. Por nga ana tjetër, këto dëshmi vërtetojnë më së miri për karakterin e Aliut, për bindjet e tij antikomuniste, për moralin e tij të lartë që të mos bëhej as vegël e as spiun i organeve të Sigurimit të Shtetit. Pikërisht këtu qëndron dhe forca morale e ketij oficeri që nuk pranoi në asnjë rrethanë që, për hir të karrierës e gradave, të binte në prehërin e shpifjeve dhe intrigave e për të marrë në qafë njerëz të pafajshëm.

Dhe ja krimi që kishte bërë Ali Bana. Se kooperativat bujqësore prodhonin më pak se në të kaluarën, kur ishin ekonomi individuale! Se kooperativat bujqësore do të prishen, siç u prishën në Jugosllavi, se kishte komentuar në rrethe të ngushta shoqërore që masat e ndërmarra në ushtri për gjoja reformim të saj, ishin gabime të rënda, që do ta dobësonin më tepër fuqinë mbrojtëse të vendit. Aty, në këtë gjyq farsë, doli dhe se i gjykuari na paska patur dijeni të plotë për një të arratisur në Jugosllavi dhe që nuk paska bërë kallzim në organet kompetente, se e ka quajtur fyerje të bënte punën e një spiuni. Kishte në këtë gjyq të improvizuar edhe akuza të tilla, me të cilat mund të akuzohet çdo qytetar që jeton në një fshat afër tregut, që ishte marrë edhe me shitblerje kafshësh(?!).

Me këto akuza qesharake e kryekëput trillime u arrestua oficeri Ali Bana, atëherë me gradën nënkolonel, kur ishte në krye të detyrës. Dhe vërtet këtu mbaroi dhe karriera e tij ushtarake, këtu u këputën ëndrrat dhe pasioni i tij, këtu filluan vuajtjet, torturat, poshtërimet e përndjekjet për tërë familjen që do të vazhdonin gjer në vitet që sollën demokracinë në Shqipëri.

Ata që e njohën dhe jetuan e punuan me Ali Banën e panë edhe kur ai doli nga burgu dhe gjithkujt i vinte keq tek shikonte jo më atë oficerin shtatlartë e energjik, që dhe syte i nxirrnin xixa në rininë e tij, por një njeri të gjymtuar, të mpakur e të plakur, të kërrusur e shterrur, por në tërë qenien e tij, në sy, në buzë, në ballë shkëlqente përsëri ylli i burrërisë shqiptare, nuk ishte shuar, por gjallëronte e ndizej ai vrulli i dikurshëm djaloshar, ruheshin ato tipare të karakterit të tij. Prandaj dhe respektohej e nderohej nga të gjithë. Dukej se prapa figurës së Ali Banës ishte zhdukur errësira dhe jeta gjallëronte përsëri. Tek ai nuk shikonin njeriun e burgosur që kishte humbur titujt, ofiqet, postet e gradat e komunizmit, por Njeriun i Madh, oficerin e nderuar, që ndonëse kishte humbur rininë e tij, kishte fituar madhështinë, respektin, dashurinë e madhe të shoqërisë, jo për mëshirë, por për karakterin, burrërinë, talentin dhe përkushtimin ndaj detyrës duke merituar kështu emrin e nderuar të një patrioti të vërtetë.

Të ishe mik e shok në atë kohë me Ali Banën ishte dhe mirë, dhe keq. Ishte mirë se kishe pranë një burrë të zgjuar e trim, një njeri të besës dhe të virtyteve shqiptare, që s'e shet as e tradhton mikun, që s'e shkel besën. Kishe mik e shok një njeri punëtor, të devotshëm gjer në sakrificë për të mirën e atdheut dhe të shoqërisë. Por ishte keq se të rrije e të bisedoje me Ali Banën shihej me një sy tjetër, si një bashkëpunëtor me një armik të Partisë e Pushtetit, që të prishte e të nxinte biografinë "e pastër".

Por Aliut nuk i munguan miqtë e shokët e vërtetë gjer sa ndërroi jete më 24 nëntor të vitit 1989. Kjo u pa dhe në varrimin e tij, ku në kortezhin e tij morën pjesë qindra njerëz, të njohur e të panjohur, që kishin dashuri e respekt për këtë burrë me gjak shqiptari të vërtetë.

Këto ditë, ndërsa flitete e përflitet aq shumë për hapjen Dosjeve të Zeza të komunizmit, për të nxjerrë në dritën e diellit masakrat monstruoze të një regjimi gjakatar, për t'u vënë gishtin atyre figurave të shëmtuara e të urryera që mbajtën në këmbë diktaturën, gjeneratorët e projektorët e masakrave dhe spiunët e mijëra viktimave e fatkeqësive që e përgjunjën këtë popull, që e përgjakën dhe e sakatuan, duhen hapur dhe ato Dosjet e Bardha, viktima të Dosjeve të Zeza, që kanë brenda virtytet e larta të shqiptarit, besën e burrërinë, qëndresën e trimërinë, dosjen e atyre që hoqën e vuajtën nga diktatura, dosjet e atyre që humbën jetën, rininë e talentin, dosjet e bardha të atyre që mbajnë brenda emrin e tyre të nderuar, siç ishte dhe Ali Bana.

Intervistë nga Kreta e dibranit Besmi Aga, tani si pjestar i Ansamblit Kombëtar të Valleve. Rruga e tij e rritjes përkrah valltërave të njohur dibran Xhevat Fana, Shaban Xhajku, Avni Ndreu deri te Rexhep Celiku e Lili Cingu

ËNDRRA DHE HAPI I **BESMIR AGËS**

Ai është një prej "shqiponjave" të valles pop ullore shqiptare, më i riu, student në Akademinë e Arteve, ëndrra e të cilit është të jetë pjesë e valles popullore shqiptare, të asaj valleje që në Dizhon të Francës vari mbi gjoksin e Shqipërisë gjerdanin e artë, të asaj valleje që të ngre në qiell e të ul në tokë, të bën me krahë...Po kush është ai? Cilët janë hapat e tij nën gjëmimet e daulles dhe vikamën e klarinetës?

Mund të prezantohemi për lexuesin e gazetës sonë?

Besmir Bexhet Aga.

Jemi njohur bashkë në Lushnjë kur u shpallët "Mbret i festivalit". U ritakuam në traget tek udhëtonim drejt Kretës. Kaluam gati një javë bashkë midis këngëve dhe valleve të Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore....A mund të m'i përshkruash këto hapa të jetës suaj që nga Lushnja, që nga momenti kur u shpallët "Mbret" dhe deri në ditët që jetuam bashkë?

Në radhë të parë ju falënderoj për punën tuaj mjaft fisnike që bëni. Për mua ishte kënaqësi që u takuam bashkë, në Lushnjë, natyrisht, për herë të parë, ku aty mora një çmim simbolik dhe ndër të tjera u evidentova. Prej asaj kohe unë kam vazhduar rrugën time në Ansamblin e Shtetit gjë të cilën unë e kam ëndërr ta vazhdoj. Sot jemi këtu bashkë.

Po më përpara ishe me Ansamblin?

Në momentin kur unë kam marrë çmimin në Lushnjë prisja të firmosja një kontratë me Ansamblin e Shtetit, një kontratë njëvjeçare. Çmimi në Lushnjë ishte një çmim i dyfishtë të cilin unë nuk e bëra publik me ju por me njerëzit e mi që më rrinin afër.

The që të jesh pjesë e Ansamblit të Shtetit është...

Është nder dhe krenari për mua.

Ky nder, kjo krenari, kjo ëndërr të obligon...

Natyrisht. Të jesh pjesë e Ansamblit të Shtetit për mua është diçka shumë e madhe. Kjo më bën që të punoj akoma më tepër duke qenë pjesë e tij. Të lodhem shumë, të djersij shumë sepse puna jonë kështu është. Tashmë ju e patë, e dini. Kur dalim në skenë për pesë minuta shpalosim një diçka mjaft të bukur, mjaft ekspresive, impulsive të valles dibrane.

Valles dibrane?

Të të gjitha valleve, natyrisht por...ne jemi dibranë.

Si ju lindi dëshira për të vallëzuar kur unë të paktën nuk e di se ke ndonjë gen valltarësh?

Është shumë e vërtetë. Mua në klasën e gjashtë, shkolla tetëvjeçare më çoi në një festë. Na çoi ne disa nxënësve që mësueses së muzikës i ishte mbushur mendja se jemi të mirë. Na çoi tek Xhevat Fana. Xhevatin ju e njihni shumë mirë. Në atë kohë ai ishte udhëheqës i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, drejtor artistik siç quhet tani. Xhevati më veçoi dhe më thotë: **"Ti djalë do të vish të aktivizohesh këtu në Qendrën Kulturore të Fëmijëve"** gjë të cilën në atë kohë nuk e dija se çfarë ishte QKF – ja.

Çfarë moshe kishe atëherë?

Klasa e gjashtë. I bije dymbëdhjetë vjeç. Prej aty më nisi një ego e brendshme të cilën nuk e jepja tek të tjerët por e mbaja përbrenda. Xhevati më ve të parin, në atë që ne quajmë solist. Këtu nisi puna ime. U aktivizova disa herë me Qendrën Kulturore të Fëmijëve, në disa festivale fëmijësh, brenda Peshkopisë dhe jashtë asaj. Më pas kalova në ansamblin e të rriturve, Ansamblin Amator Artistik "Dibra", siç quhet sot. Atje kam pas një bashkëpunim shumë të mirë me të gjithë ata njerëz të cilët i falënderoj, ata të cilët më kanë konsideruar si shok, megjithëse unë isha shumë i vogël. Dua që ti përmend këtu, në ishullin e largët të Kretës, të gjithë. Avni Ndreu ka qenë ai me të cilin kam punuar në fillim, në pjesën kur tashmë isha më i rritur, në gjimnaz, pa harruar kurrë Xhevat Fanën, kurrë. Me Avni Ndreun kemi qenë si shokë. Nga Shaban Xhajku unë mësova shumë.

"Dua që ti përmend këtu, në ishullin e largët të Kretës, të gjithë ata që më ndihmuan të bëhem valltar: Avni Ndreu, Xhevat Fanën, Shaban Xhajku... Shaban Xhajkut "vidhja" jo vetëm talentin e tij të valltarit të madh dibran, por edhe mënyrën se si bërtiste, si kërcente, si lëvizte dorën, kokën, këmbën, çdo gjë.

Nga njohja profesionale, nga shkolla që po bëj, shpesh u drejtohem videove të Xhevat Fanës, që për mua mbetet i paarritshëm për virtuozitetin tij. Unë ndjej kënaqësi kur i shoh ato, kënaqem dhe më rrëqethet gjithmonë trupi

Ai më bërtiste shumë kurse unë i "vidhja" jo vetëm talentin e tij të valltarit të madh dibran por edhe mënyrën se si bërtiste, se si kërcente, se si lëvizte dorën, kokën, këmbën, çdo gjë. Me Veli Vraniçin, drejtorin që më ka respektuar dhe inkurajuar shumë. Me Përparim Tomçinin, kompozitorin e shquar dibran dhe me të tjerë. Të gjithë këta i përshëndes prej ishullit të Kretës ku jam pjesë tashmë e Ansamblit Kombëtar. Realisht prej tyre kam dalë.

Çfarë shkolle vazhdon?

Unë jam në vitin e katërt, në fakultetin e artit skenik, Akademia e Arteve, dega koreografi. Këtë vit shpresoj të diplomohem.

Keni marrë ndonjë temë të veçantë për diplomën ?

Temën nuk e kam zgjedhur akoma sepse të tilla janë procedurat por shpresoj shumë shpejt ta zgjedh. Tashti jemi në tetor. Në fund të dhjetorit besoj se do ta kem të zgjedhur.

Çfarë të pëlqen më shumë?

Siç themi ne dibranët, me qenë kësmet, do ta...

Çfarë të pëlqen më shumë si temë, e kam fjalën?

Nuk e kam vendosur. Unë i bëj të gjitha zhanret në shkollë; baletin klasik, baletin modern, baletin kontemporan siç quhet sot, vallen popullore që ju tashmë e dini që unë e kam shumë për zemër. Shpresoj që do ta trajtoj në diplomën time, në zhanrin popullor duke e ndërtuar me rite të pa konsumuara dhe duke i moderuar njëkohësisht ato. Fjala vjen "Dasma dibrane" apo rite të ndryshme, thjesht nga treva që unë mendoj se e njoh sado pak.

Po mirë, përveç këtyre emrave që përmendët çfarë ke mësuar nga brezi para këtyre valltarëve?

Nga Dibra e keni fjalën?

Po. Vetëm nga Dibra ku keni nisur hapat e parë të kërcimit.

Të them të drejtën kisha dëgjuar shumë për Xhevat Fanën. Tashti, nga njohja profesionale nga vetë shkolla që po bëj, shpesh u drejtohem videove të atij dhe për mua ai mbetet i paarritshëm për virtuozitetin tij. Unë ndjej kënaqësi kur i shoh ato, kënaqem dhe më rrëqethet gjithmonë trupi. Kisha dëgjuar për Izet Dardeshin, një kërcimtar shumë i karakterit të cilin e kam në video dhe e ruaj me shumë pasion.

Jeton Izeti ?

Nuk e di. Këto të dy i kisha dëgjuar por realisht Xhevati, për mua, është i paarritshëm.

Cilat nga vallet e Dibrës kanë jehonën më të madhe në shpirtin tuaj?

Vallja e "Xhafer Kabës". Për të qenë i sinqertë unë deri në momentin që hyra në Akademinë e Arteve vallet e trevës nuk i njihja shumë mirë. Natyrisht edhe tani nuk pretendoj



Në foto: Besmir Aga në Kretë, si pjestar i Ansamblit Kombëtar të Valleve

që i njoh sepse vallja në Dibër është e pafund...

Arë e papunuar.

Absolutisht. E kisha dëgjuar vallen e "Xhafer Kabës" por nuk e dija origjinën ashtu siç di tani ritmin që ka, shoqërimin, kërcimin...

Mua, në një nga vallet e Ansamblit, më zuri syri pikërisht disa nuanca nga ajo valle karakteristike, valle ku mimika e fytyrës, këmba e çalë, trupi i lëkundur formojnë një nga perlat e lëvizjes populloret valles shqiptare.

Natyrisht. Përpunimi ka arritur kulmin nga mjeshtrit tanë siç ju i njihni shumë mirë si Panajot Kanaçi, korifeu i koreografisë popullore shqiptare siç e quajmë ne, Besim Zekthi dhe të tjerë.

Unë dëgjova, prapa meje në Lushnjë një nga solistet më të njohura të Ansamblit, Lili Cingun tek fliste me hiperbola për ty kur të pa në skenë. Çfarë njohje ke me Lili Cingun?

Lili Cingu është një ndër kërcimtaret më të mira të Ansamblit të Shtetit. Ajo ngelet, po e përsëris, ngelet yll i valles popullore shqiptare. Me të nuk kam asnjë lidhje përveçse jam takuar një herë të vetme në Ansamblin e Shtetit kur bëja prova. Një ditë vjen aty dhe më shikon. Merr vesh që jam dibran, që jam në Akademinë e Arteve dhe kaq. Ajo kishte një simpati për mua. Kjo është e gjitha.

Rexhep Çeliku, Mjeshtër i Madh, më foli jashtëzakonisht mirë për ju...

Unë atij i them profesor. Për mua realisht ai është profesor. Nuk mund t'i them Rexhep. Më ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë. Kam punuar mjaft, mjaft, mjaft derisa me punën gjithmonë të atij dhe me vlerësimin që ai më ka bërë, unë arrita të fitoj një konkurs, të fitoj një kontratë me Ansamblin e Shtetit. Unë e respektoj shumë atë njeri dhe i përulem me respekt.

Të ardhmen si e shikon?

Mendoj që... Natyrisht shkolla është parësore. Dua që ta mbyll diplomën mirë, shumë mirë. Kur unë të jem pjesë definitive e Ansamblit të Shtetit atëherë ëndrra ime do të realizohet.

Faleminderit dhe lart e më lart ta hedhësh hapin në vallen popullore shqiptare.

Faleminderit edhe Ju. Unë ju përshëndes Ju dhe zonjën tuaj mësuese Natashën e shkollës "Demir Gashi" të Peshkopisë, familjen tuaj dhe ju uroj mbarësi.

ABDURAHIM ASHIKU

Oda Dibrane hap dyert

Nga data 30 tetor - 1 nëntor, për tre ditë me radhë, do të mbahet në qytetin e Peshkopisë edicioni i 13-të i Festivalit "Oda Dibrane". Festivali organizohet nën përkujdesjen e Bashkisë dhe Qendrës Kulturore, Peshkopi.

Sipas drejtorit të Qendrës Kulturore Peshkopi, z. Veli Vranici, këtë vit, përveç grupeve kulturore nga vendi, Kosova dhe Maqedonia, do marrë pjesë edhe një grup nga qyteti Giurgiu i Rumanisë.

Nga Kosova në këtë edicion do marrin pjesë grupi i Mitrovicës, të cilin do ta shoqërojë kryebashkiaku i qytetit, ish kryeministri i Kosovës, Bajram Rexhepi, grupi i Deçanit dhe grupi "Azem Bejtja" i Prishtinës.

Nga Maqedonia do marrin pjesë në konkurrim Shoqëria Kulturore Artistike "Derveni"- Shkup, "Jehona e Malësisë" - Tetovë, "Valët e Liqenit"- Strugë si dhe Shoqëria Kulturore "Haki Stërmilli", Dibër e Madhe.

Nga vendi, këtë edicion do marrin pjesë grupet folklorike të Vlorës, Gjirokastrës, Lushnjës, Kavajës, Burrelit dhe Bulqizës

Festivali "Oda Dibrane" ka nisur jetën e tij që në vitin 1994 dhe është kthyer tashme në një takim - traditë ku kjo e fundit pasqyrohej në një gjini krejt të veçantë, në atë të këngës dhe valles humoristike, ritit dhe alegorisë.

Ky festival ka për qëllim të bashkojë artistët shqiptarë ngado që ndodhen pavarësisht nga kufijtë me idenë që "Oda Dibrane" do të jetë mikpritëse e "Odës Shqiptare". Ky është një takim origjinal në llojin e vet, i cili synon të rizgjojë vlerat e papërsëritshme të kulturës sonë në kuadrin edhe të turizmit kulturor. Në këtë Festival paraqiten rite të lashta si dhe vegla karakteristike muzikore mbarëshqiptare.

Festivali, çdo vit ka sjellë një kontribut të çmuar sipas specialistëve në kulturën shqiptare dhe tregues për këtë janë edhe kërkesat e shumta për pjesëmarrje në këtë veprimtari nga grupe të ndryshme nga vendi, Kosova e nga shqiptarë të Malit të Zi dhe Maqedonisë. Pjesë e suksesit të tij janë edhe atmosfera festive që krijohet në qytet. Numri i pjesëmarrësve ka ardhur gjithmonë në rritje dhe po ashtu është zgjeruar edhe gjeografia e tyre. Grupet pjesëmarrësve hyjnë në një sistem konkurrimi, rezultatet e të cilit shpallen natën e tretë.

Këtë vit në jurinë e festivalit do marrin pjesë këngëtari kosovar Ilir Shaqiri, valltari i njohur i Ansamblit të Shtetit Rexhep Çeliku, koreografi dibran Xhevat Fana, Drejtoria e Institutit të Folklorit, Afërdita Onuzi, etj.

Në ditët e Festivalt zhvillohen gjithashtu edhe biseda të ndryshme, ekspozitë fotografike me motive folklorike, ekspozitë e arteve figurative të piktorëve dibranë, vizita në monumente të kulturës së zonës, etj.

E veçanta e këtij viti është një ekspozitë etnografike e shqiptarëve të Maqedonisë, e cila do të hapet të premten në ora 10. Pastaj do shoqërohet me një marrshim të grupeve pjesëmarrëse në bulevardin "Elez Isufi".

"Oda Dibranë" këtë vit organizohet me mbështetjen kryesore nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Shoqëria e Sigurimit SIGAL si dhe kompanitë private "Aurora Group dhe "Ricku Sh.p.k."

speciale

Mbyllet festivali "Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2008". Suksesi i festivalit vjen bashkë me premtimin për një mbështetje institucionale të qeverisë së Maqedonisë, duke e kthyer kështu në një festë të përvitshme

Dibër e Madhe - Përfundoi Festivali i shtatë "Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2008"

Dibër, shpalosen vlerat teatrore gjithkombëtare



Nga **REXHEP TORTE**



Ne foto: Pamje nga shfaqja "Hiqe ministrin nga priza", Teatri Kombëtar, Gjakovë

Edicioni i shtatë i Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2008" që zgjati nga data 5-12 tetor ku morrën pjesë trupa teatrore nga Maqedonia ,Shqipëria dhe Kosova, ishte manifestim lumturues për tërë artdashësit. Spektatorët dibranë sëbashku me mysafirët patën rastin të shijojnë një eveniment me vlera të bukura teatrore. Secili artdashës do ta kishte dëshiruar të jetë në sallën e madhe të Qendrës për Kulturë në Dibër në këtë eveniment kulturor, ku u shfaqën 9 shfaqje.

Këtë festival me praninë e tyre e nderuan artistët e popullit mes tyre edhe Lazër Filipi. Në mesin e tyre ishin edhe Gëzim Ostreni, Abdylaqim Ademi, deputetët, Xhevat Ademi, Ermira Mehmeti, Luljeta Marku, artistë të merituar dhe kryetarët e komunave nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova.

Ky festival përfundoi me Teatrin Kombëtar nga Gjilani, i cili shfaqi komedinë "Kumbara" të autorit Angjelo Beolko-Rucante, me regji të Erson Zymberit.

Juria e përbërë nga Dr.Prof. Nebi Islami-Kosovë, Klajdi Marku- Shqipëri dhe Adem Karaga-Maqedoni, shpalli fituesit e çmimeve.

Dr. Prof. Nebi Islami me këtë rast, theksoi se: "Jam shumë i nderuar që kam qenë kryetar i jurisë.Juria me këtë rast ka bërë një punë të përgjegjshme dhe të ndershme dhe çdo vendim e ka marë në mënyrë unike. Nuk kemi pasur asnjë konflikt eventual lidhur me shpërblimet e caktuara. Ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe mikpritjen tuaj".

Klajdi Marku: "Të gjithë kemi një emocion të përbashkët, jeni publiku më i mrekullueshëm në tërë Shqipërinë.

Adem Karaga "Dibra din të krijojë emocionin e vet. Ky publik është i mrekullueshëmm, përshëndes tërë aktorët për punën dhe kontributin e dhënë ".

Çmimi inkurajues i takoi aktores Egzona Ademi për shfaqjen "Togeri i Insismorit" të Teatrit Profesionist-Prizren.Aktorja joprotagoniste u shpall zonja Natasha Andoni, për shfaqjen " Ju ftojmë në dasmën e babait " të Teatrit " A.Z.Çajupi "-Korçë.Aktori joprotagonist u shpall aktori Hysen Bashhysa, për rolin në tragjikominë " Tango " të Teatrit " A.Mojsiu "-Durrës,Çmimi special, që e jep kryetari i komunës së Dibrës, iu dha aktorit Musa Isufi për shfaqjen " Kufomat e gjalla " të Teatrit Profesionist –Kumanovë. Aktorja më e mirë e festivalit që e fitoi çmimin " Qemal Ajdini " u shpall Adriana Matoshi për rolin në komedinë " Kumbara " të Teatri Kombëtar-Gjilan.Aktori më i mirë i festivalit që e fitoi çmimin " Qemal Ajdini " u shpall aktori Muharrem Hoxha për rolin në komedinë " Ju ftojmë në dasmën e babait " të Teatrit " A.Z.Çajupi-Korçë ".Çmimin për regji më të mirë të festivalit e fitoi Driada Dervishi për tragjikominë " Tango " të Teatrit " A.Mojsiu "-Durrës. Shfaqja më e mirë e festivalit që fitoi çmimin " Sulejman Pitarka " u shpall "Hiqe ministrin nga priza " e Teatrit Kombëtar-Gjakovë.

Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës së Madhe nën patronatin e të cilit u mbajt ky festival, duke deklaruar të mbyllur këtë festival, theksoi se : " Këtu u thanë shumë fjalë, u derdhën shumë emocione.Që nga debutantët që hoqën tremën për herë të parë por edhe aktorët e meritуar që na kënaqën me rolet e tyre.Regji të mrekullueshme, skenografi të mrekullueshme, skenare të mira dhe trupa profesioniste nga të gjitha trojet etnike.Asgjë nuk u tha gabim këtu.Ne këtu në Dibër të Madhe dëshmuam se dijmë të jetojmë bashkë, të frymojmë bashkë, të krijojmë kulturë bashkë. Në fillim të festivalit kishte dallime të mëdha mes trupave që vinin nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia. Por siç tha edhe juria e nderuar, tani kemi shfaqje mjaft cilësore edhe nga Maqedonia edhe nga Kosova. Uroj që edhe vitet që vijnë në këtë skenë të jenë të pranishme sa më shumë trupa nga të gjitha trojet etnike.Ne dibranët do të mundohemi me bukë e kripë, por me zemër të madhe tju presim sërish. Falenderoj drejtorin e festivalit, stafin e tij me djem të mrekullueshëm që nuk u kursyan duke bërë vetëm nga tre orë gjumë, të jenë pranë aktorëve të mrekullueshëm.Mirëse të vini edhe viteve tjera ".

Ylber Nuredini, drejtor i festivalit, u shpreh se: "Përgëzoj për unitetin në ndarjen e çmimeve jurinë si edhe kritikët Prof.Dr. Adriatik Kallulli, Prof Dr. Nebi Islami, Prof.Dr. Josip Papagjoni dhe Prof. Selajtin Salihu, për angazhimin e tyre gjatë analizës së shfaqjeve, përshëndes mediat që pasqyruan ecurinë e këtij festivali, të gjitha trupat teatrore që shpalosën veprat e tyre në skenën dibrane ".

Gjatë dorëzimit të çmimeve u thanë fjalë mirënjohje për publikun, pjesëmarrjen e femrave në sallë si respektuese të vlerave kulturore, për aktorët, për ata që janë lodhur me djersë e mundim e që kanë arritur rezultate shumë të mira. Ky festival tregoi se ka një traditë. Gëzimi ynë është që teatri shqiptar vitet e fundit ka ecur përpara. Me punën e autorëve, aktorëve dhe regjisorëve ka mbëritur që një gjeneratë e re aktorësh të ketë vlera për t'ia prezentuar Evropës dhe për të marë shpërblime edhe në skenat evropiane. Ky është publik i përzemërt që i bën artistët të ndjehen lirshëm.

Fituesve të çmimeve iu dorëzuan mirënjohje, skultura artizanale druri dhe të holla.

Fituesit duke u falenderuar për çmimet që i morën, theksuan respektin për spektatorin dibran dhe gatishmërinë e tyre për suksese më të mëdha në të ardhmen.

Në pritje të vendimeve të jurisë para spektatorëve u shfaq një program kulturor ku para spektatorëve Llazër Filipi recitoi një monolog të Aleksandër Mojsiut, Pajazit Kurtishi vargje nga " Bagëti e Bujqësi " të Naim Frashërit, kurse maestrot Jeta Starova - Mehmeti në flautë dhe Ermal Mehmeti në violinë, luajtën pjesë të zgjedhura të muzikës së përpunuar.

- Shfaqja me e mirë që fitoi çmimin "Sulejman Pitarka", u shpall "Hiqe ministrin nga priza"- Teatri Kombëtar, Gjakovë
- Regjisorja më e mirë u shpall Driada Dervishi, teatri "A.Moisiu", Durrës me tragjikomedinë "Tango" të autorit Slavomir Mrozhek
- Aktorja dhe Aktori më i mirë, që fituan çmimin "Qemal Ajdini", u shpallën Adriana Matoshi, Gjilan dhe Muharrem Hoxha, Korçë
- Çmimi inkurajues i takoi aktores Egzona Ademi për shfaqjen "Togeri i Insismorit"
- Aktorja joprotagoniste u shpall zonja Natasha Andoni, për shfaqjen " Ju ftojmë në dasmën e babait"
- Aktori joprotagonist u shpall aktori Hysen Bashhysa, për rolin në tragjikominë "Tango"
- Çmimi special, që e jep kryetari i komunës së Dibrës, iu dha aktorit Musa Isufi për shfaqjen "Kufomat e gjalla"

ARGËTIM FIDA:

"Uroj që edhe vitet që vijnë në këtë skenë të jenë të pranishme sa më shumë trupa nga të gjitha trojet etnike.Ne dibranët do të mundohemi me bukë e kripë, por me zemër të madhe tju presim sërish"

KRONIKA E FESTIVALIT TË TEATROVE NË FAQET 10-12

Rruga Arbërit nr. 30
speciale

Zijadin Murtezi: Kam shëtitur Suedinë, Norvegjinë, Gjermaninë, kam marë pjesë në shumë festivale e festivale dhe kam marë shumë shpërblime ... nuk ekziston kënaqësi më e madhe kur gjendesh mes publikun dibran ...

PJESMARRJA



Ja shfaqjet konkuruese

Në kuadër të manifestimit "Ditët e kulturës-Dibra 2008" nga data 5-12 tetor në Qendrën kulturore në Dibër të Madhe, nën patronatin e Komunës Dibra e Madhe, u mbajt Festivali "Teatri Shqiptar në Maqedoni- Dibra 2008".

Ky festival, i shtati me radhë, filloi me dramën "**Historia e zooparkut**" të autorit Edëard Ollbee me regji të Ylber Nuredinit, luajtur nga Teatri Profesionist-Dibër e Madhe.

Në ditët në vazhdim u shfaq drama "**Togeri i Inismorit**" i autorit Martin Mcdonagh, me regji të Ilir Bokshit, luajtur nga Teatri Profesionist-Prizren.

Me 7 shtator në ora 19 komedia «**Ju ftojmë në dasmën e babait**» e autorit Petrit Koçibelli me regji të Genti Bejko.

Më datë 8 tetor në ora 18 u shfaq drama "**Kush më ka faj se jam shqiptar**" shfaqje përshëndetëse e autorit dhe regjisorit Enver Petrovci, luajtur nga Teatri « Bylys »-Fier, ndërsa në ora 21 drama «**Kufomat e gjalla**» e autorit Shkëlzen Halimi, me regji të Zijadin Murtezit, luajtur nga Teatri Profesionis i Kumanovës.

Pjesët teatrore të shfaqura:

- "Historia e zooparkut"
- "Togeri i Inismorit"
- "Ju ftojmë në dasmën e babait"
- "Kush më ka faj se jam shqiptar"
- "Kufomat e gjalla"
- "Vrasësit i lam pas"
- "Tango"
- "Hiqe ministrin nga priza"
- "Kumbara"

Më 9 tetor në ora 19 drama "**Vrasësit i lam pas**", e autorit Teodor Laço me regji të Roland Minga, luajtur nga Teatri « Petro Marko »-Vlorë.

Më 10 tetor në ora 19 tragjikomia «**Tango**» e autorit Slavomir Mrozhek me regji të Driada Dervishi, luajtur nga Teatri « A.Mojsiu »-Durrës.

Më 11 tetor në ora 19 drama "**Hiqe ministrin nga priza**" e autorit Erik Idile me regji të Ilir Bokshi, luajtur nga Teatri Kombëtar-Gjakovë.

Më 12 tetor në ora 19 komedia «**Kumbara**» e autorit Angjelo Beolko-Rucante me regji Erson Zymberi, luajtur nga Teatri Kombëtar-Gjilan.

Hapjen solemne të festivalit e bëri Argëtim Fida, kryetar i komunës, ndërsa vlerësimi shfaqjeve u bë nga kritikët Prof.Dr.Adriatik Kallulli, Prof.Dr. Josip Papagjoni, Prof.Dr. Nebi Islami dhe Prof.Dr. Selajtin Salihu.

Dibra e Madhe u bë kështu arena e vlerave teatrore mbarëshqiptare, çka e tregoi edhe interesimi i madh i publikut dibran.

NATA E PARË

Dibranët urojnë mirëseardhjen

Më 5 tetor, filloi Festivali i shtatë me radhë "Teatri shqiptar në Maqedoni-Dibra 2008", ku morën pjesë 9 trupa teatrore shqiptare nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova. Sponsorë kryesor është komuna e Dibrës së Madhe, ndërsa ndihmojnë edhe Ambasada e Hollandës, « Banjat e Dibrës-Capa » dhe Njësia rajonale e Bankës Ekonomike.

Argëtim Fida,kryetar i komunës së Dibrës së Madhe duke e deklaruar të hapur këtë festival, ndër të tjera tha: « Nga viti në vit në Dibër u krijua dashamirësia për teatrin dhe këtyre ditëve Dibra do të jetë qendër e kulturës së tërë trojeve shqiptare.Edhe ky festival i përjetoi fortunat ndaj tij, qoftë të obstruksioneve, qoftë të pengesave financiale, por mbisundoi dashuria e dibranëve për teatrin që i mposhti problemet. Falenderoj edhe trupat teatrore që nuk morrën parasysh pengesat që dikush i shpifte, por erdhën dhe u paraqitën me shfaqjet e tyre dhe kështu do të veprojnë edhe në të ardhmen dhe ky festival do të jetojë për mot të moteve. Pushteti vendor apelon që ky festival të bëhet institucional. Në mungesë të vullnetit të pushtetit qëndror në dy vitet e kaluara, komuna e Dibrës edhe pse e vogël dhe me buxhet të pamjaftueshëm mori mbi supet që ky festival të mbijetojë. Jemi drejtuar për ndihmë edhe deri te disa institucione si Mobimaku, Telekomi etj. dhe shpresojmë në ndihmën e tyre. Në netët që vijojnë në mesin tonë do të jenë të pranishëm edhe Ambasadorja e Hollandës, ministra, deputetë dhe kryetarë bashkishë nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova. Ndjehuni si në shtëpinë tuaj. Festivalin e bëjmë me mjete të redukuara, por me zemër të gjerë. Dibranët do të dijnë të respektojnë me mikpritje. Këto takime nuk kanë dhënë misionin e tyre vetëm në art e kulturë, por edhe në njohjen e ndërsjellë mes shqiptarëve. Këtyre ditëve Dibra do të jetë qendër e kulturës shqiptare », përfundoi Fida.

> Argëtim Fida: "Nga viti në vit në Dibër u krijua dashamirësia për teatrin dhe këtyre ditëve Dibra do të jetë qendër e kulturës së tërë trojeve shqiptare.Edhe ky festival i përjetoi fortunat ndaj tij, qoftë të obstruksioneve, qoftë të pengesave financiale, por mbisundoi dashuria e dibranëve për teatrin që i mposhti problemet. Falenderoj edhe trupat teatrore që nuk morrën parasysh pengesat që dikush i shpifte, por erdhën dhe u paraqitën me shfaqjet e tyre dhe kështu do të veprojnë edhe në të ardhmen dhe ky festival do të jetojë për mot të moteve".



Në foto: Pamje nga shfaqja «Historia e zooparkut» e Teatrit Profesionist të Dibrës së Madhe

> Linja qëndrore, dramaturgjike e kësaj drame është se në botën e sotme njërëzit kanë përgjegjësi të përkujdesen për të gjitha shtresat e kësaj shoqërie në aspektin universal

Në natën e parë të festivalit para artdashësve u paraqit "Teatri Profesionist i Dibrës së Madhe " me shfaqjen përshëndetëse « Historia e zooparkut » e autorit Edëard Ollbee, me regji të Ylber Nuredinit dhe me rolin e Piterit luajtur nga Nimon Muçaj dhe të Xherit nga Ylber Nuredini.

Pas shfaqjes regjosori Ylber Nuredini, deklaroi se: "Linja qëndrore, dramaturgjike e kësaj drame është se në botën e sotme njërëzit kanë përgjegjësi të përkujdesen për të gjitha shtresat e kësaj shoqërie në aspektin universal. Duke mos e bërë këtë lindin ngjarje dhe situata nga më të ndryshmet siç është rasti që sonte e shfaqëm këtu.Xheri në pamundësi për të arritur qëllimet e veta elementare, vendos t'i jep fund jetës.Mirëpo me që nuk e ka guximin ta kryej vetë, takon Piterin në një park qëndror të Nju Jorkut përmes së cilit realizon idenë e vet. Mesazhi i kësaj shfaqje është se te të gjithë njerëzi në moment të caktuar zgjohet gjeni shtazarak që e kemi brenda vetes sonë ».

NATA E DYTË

Prizrenasit me "Togeroi i Inismorit" rrëmbejnë vëmendjen e spektatorit

Në mbrëmjen e dytë të festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2008" para publikut artdashës dibran u paraqit Teatri Profesionist nga Prizreni me dramën dramën "Togeroi i Inismorit" të autorit Martin Mcdonagh, me regji të Ilir Bokshit. Kjo pjesë teatrore me një kolazh skenografie, kostumografie dhe muzikë të qëlluar, nëpërmjet regjisë dhe aktrimit në mënyrë të qëlluar dhe shumë të fuqishme dha një tabllo reale dhe trishtuese të përditshmërisë sonë.

Aktorët Lulzim Guheli në rolin e Patrikut, Luan Jaha, në rolin e Donit, Adrian Morina,në rolin e Bejrit,Egzona Ademi,në rolin e Merit, Ernest Malazogu,në rolin e Kristit,Fatos Kryeziu,në rolin e Brendonit, Shkëlzen Veseli,në rolin e Xhejmsit dhe Fikrim Morina,në rolin e Xhoit, edhe aktorë të rinj për nga mosha, treguan mishërim me rolet e besuara, luajtën në mënyrë të shkëlqyer dhe dëshmuan pjekuri të padiskutueshme skenike drejt një ardhmëri të sigurtë dhe të sukseshme në profesionin e tyre skenik.

Ilir Bokshi, regjisor i kësaj pjesë teatrore, deklaroi se: "Kjo shfaqje është një tragjikomedi tipike britanike dhe ka një mesazh të fuqishëm, se gjërat në jetë nuk duhet marrë me gjaknxehtësi dhe grindje, sepse kjo sjell luftëra dhe vllavrasje, por gjërat duhet menduar dhe trajtuar me gjakftohtësi për të patur harmoni dhe paqe gjithandej".

Në pyetjen sa është i kënaqur me interpretimin e roleve nga ana e aktorëve , regjisori Bokshi, u përgjigj se," në përgjithësi jam shumë i kënaqur edhe pse sonte shfaqja ka shkuar pak më ndryshe, për arsye se patëm patëm pak kohë për tu përshtatur në këtë skenë, në këtë sallë dhe në këtë sistem të zërimit dhe ndriçimit. Kjo don të se shfaqja humbi shumë për shkak të përshtatjes në këtë situatë. Megjithatë unë jam shumë kënaqur me angazhimin dhe rolet që interpretuan dhe kjo shfaqje bën pjesë në shfaqjet e mira që kam bërë unë. Falenderoj shumë publikun dibran për ndjekjen me vëmendje të kësaj shfaqje dhe se është ndjenjë e posaçme të lozësh para këtij publiku të mrekullueshëm", tha në fund regjisori Ilir Bokshi ».

speciale

Roland Minga: Publikun dibran tani kemi filluar ta shijojmë ne protagonistët e skenës, dhe publiku dibran këtë na e kthen me kënaqësi dhe duartokitje.

NATA E TRETË

"Ju ftojmë në dasmën e babait"

Korçarët vijnë me komedinë e Petrit Koçibellit dhe me regji të Genti Bejkos

Në ditën e tretë të Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2008" para publikut u paraqit Teatri "A.Z.Çajupi" nga Korça me komedinë «Ju ftojmë në dasmën e babait», shkruar nga Petrit Koçibelli, me regji të Genti Bejko.

Aktorët Muharrrem Hoxha, Natasha Andoni, Petrika Riza, Zamira Kita, Albana Prodani dhe Xhasika Muhaxhiri, si një buqetë mikse trëndafilash dhe gonxhe trëndafili, përkatësisht aktorë me me shumë e më pak përvojë, dëshmuan një përmbushje të mrekullueshme të ndërsjellë të roleve skenike, të angazhimit dhe të pasqyrimit të talentit në spikatjen e roleve që i luajtën dhe që u përshëndetën frenetikisht nga publiku.

Gent Bejko, pas shfaqje u shpreh se: «Pjesa flet për një familje të varfër e cila disi edhe nga naiviteti i vajzës, e cila bëhet pjesëmarrëse dhe i mbushin mëndjen babait që të martohet. Është një personazh tipik, një lloj egoje, si cinik i shtëpisë i cili ka për qëllim jo vetëm të hakmeret për një histori të vjetër karshi babait të kësaj familjeje, por e çon harbutërinë e tij deri atje, sa i mer edhe atë që i ka mbetur katër muret e një shtëpie».

Ndërsa lidhur me mesazhin që jep kjo komedi, ai theksoi se: «Kjo është një komedi mbi groteskun e varfërisë që njeriun e shtyjnë drejt veprimeve të tilla. Është një pjesë që më shumë se kurrë është aktuale për situatat nëpër të cilat kalon Shqipëria, sidomos qytetet, sepse ndoshta në kryeqytet brenda vijës së verdhë nuk ndihet, por sapo e kalon vijën e verdhë të kryeqytetit i gjen shpesh dramat e tilla nëpër familjet tona.Kjo është informata groteske, sepse nuk ndodh që familjet, vajzat apo nënat të martojnë babain, por idea është se çdo gjë mund të ndodh për arsye të varfërisë».

Lidhur me publikun dibran, regjisori Bejko, tha se: «Publiku dibran ishte fantastik dhe kjo u vërejt edhe nga pritja dhe përjetimi që i bënë shfaqjes dhe aktorëve të saj".



Në foto: Pamje nga komedia "Ju ftojmë në dasmën e babait"

NATA E KATËRT



"Mesazhi i kësaj drame është fati ynë i përditshëm lidhur me intelektualët, qofshin ata shkrimtarë, artistë, piktorë, skulptorë apo aktorë"

Kumanovarët sovranë të skenës

Në ora 21 të ditës së katërt të këtij festivali para publikut dibran u paraqit edhe Teatri Profesionist i Kumanovës me shfaqjen "Kufomat e gjalla" të autorit Shkëlzen Halimi me regji të Zijadin Murtezit. Aktorët Musa Isufi, në rolin e Kibsit, Mendim Murtezi, në rolin e hajnit dhe Sefedin Shabani, në rolin e popullit, skenës dhe shikuesve u dhanë një dinamizëm të fuqishëm aktrimi, gjë që publiku e shpesh e shpërbleu me duatrokitje.

Me ngulmin për mbrojtjen e ndërgjegjes si libri më i mirë moral me të cilin duhet vazhdimisht të konsultohemi, kundër përzierjes së politikës në ndërgjegjen e njerëzve, nëpërmjet caktimit të vijës së kuqe mes mençurisë dhe çmendurisë, nëpërmjet ankthit të luftës mes durimit si zë i ndërgjegjes, pritjes dhe shpresës, idealizmit dhe atdhetarisë plot lajka, kjo shfaqje nxorri në spikamë edhe shqetësimin që ndjejnë njerëzit e ndershëm, kur edhe tradhëtarëve gjatë varrimit u thuhet "u qoftë dheu i lehtë".

Zijadin Murtezi, duke folurpër konceptin regjisorial, tha se "Mesazhi i kësaj drame është fati ynë i përditshëm lidhur me intelektualët, qofshin ata shkrimtarë, artistë, piktorë, skulptorë apo aktorë. Mjaft më me politika, me nënën parti. Sepse tashmë masa e intelektualëve ka ngelur në fundërinë. Nënat parti ikin prej intelektualëve, prej shkrimtarëve. Ne kemi de jure gazetarë, aktorë e shkrimtarë, por kur ata duhet të dëshmohen me vepra, ata nuk duken, nuk po shkruajnë, nuk po e kryejnë si duhet misionin e tyre. Kjo vjen si rezultat sepse fatin tonë po na e kurdisin nënat parti, që imponojnë edhe tekstet edhe aktivistët, edhe pse aktivistët duhet ta kenë vendin në parti, ndërsa artistët në art".

Për rolet e aktorëve, ai shtoi se: "Si intelektual dhe si aktor , mund të them se shfaqja e sontme ishte shpirti im dhe mesazhi im i qëlluar. Me publikun dibran jam që në vitin 1972. Kam shëtitur Suedinë, Norvegjinë, Gjermaninë, kam marë pjesë në shumë festivale e festivale dhe kam marë shumë shpërblime, por kur i kthehesh vetvetes, e të gjitha i ke pranë teje duke filluar nga arti, kombëtarja, autori, aktorët, nuk ekziston kënaqësi më e madhe kur gjendesh mes publikun dibran që dallohet shumë nga të tjerët".

NATA E PESTË



"Vrasësit i lamë pas"

Në Ditën e pestë të këtij festivali para art dashësve dibranë u paraqit Teatri « Petro Marko » i Vlorës me dramën «Vrasësit i lamë pas» të autorit Teodor Laço me regji të Roland Minga. Aktorët Arben Tartari, Astrit Mamaj, Artan Islami,Roland Minga, Desantila Kristo, Ilirian Ali, Lavdimir Abilaliaj dhe aktorët e Teatrit Rinor-Vlorë,me rolet që i interpretuan dëshmuan profesionalizëm të vërtetë duke qenë që nga fillimi e gjer në fund gjigaqndë skenikë.

Ne prologun e kësaj shfaqje thuhej,"Të nderuar miq, dashamirë të teatrit.Njgjarjet që ju ftoj t'I përjetojmë sëbashku janë një pjesë e jetës sime, por ndoshta edhe e jetës së ndonjërit prej jush. A nuk jeni gjendur ndonjëherë në mes të një udhëkryqi, kur ju duhet të zgjidhni midis dashurisë dhe urrejtjes, midis faljes që të fisnikëron dhe hakmarrjes që të egërson. Ne ishim shumë, u ngritëm mes të mirës dhe fituam, por si do të sillemi me të mundurit. Të vazhdojë dhuma e përdorur si rrugë deri në mbëritjen e qëllimit, apo do të vendoset paqja".

Roland Minga, regjisor, pas shfaqjes u shpreh se: "Mesazhi i kësaj shfaqje është se të dish të administrosh pushtetin është problemi numër një i politikës Ballkanike sot.Nuk është problem i madh për ta marë pushtetin me format nga më të ndryshme që ne i njohim, por problemi është sa jemi ne të zotët që ta administrojmë fuqishëm këtë pushtet. Ky është problemi shqiptar dhe ai Ballkanik. Ngjarja është goxha e thjeshtë.Aksidentohet një urrejtje me qëllime të caktuara për të marë pushtetin.Problemi është që këtë pushtet do ta mari krahu i forcës apo krahu i politikës,në këtë rast krahu i paqes.Shpeshherë te na dhe në botë ndodh që pushtetin e merr krahi i agresivitetit, krahu i cili nxit hakmarrjen dhe të gjitha ekseset e tjera të shoqërisë në të cilën jetojmë". Lidhur me interpretimin e roleve, ai tha se,"Kjo shfaqje u bë pas një distance kohore dhe ajo që ne dëshironim në këtë shfaqje ishte vendosja e karaktereve në qytetarri.Pra nëqoftëse në pjesën e parë të shfaqjeve dhe në fillim të premierës shfaqja ishte në momentet konsolidimit të karaktereve , në shfaqjet e tanishme neve kemi tentur që personazhet t'i fusim midis qytetarëve. Publikun dibran tani kemi filluar ta shijojmë ne protagonistët e skenës, dhe publiku dibran këtë na e kthen me kënaqësi dhe duartokitje. Kam përshtypjen se në këtë gjë publiku dibran është i veçantë"

Rruga Arbërit nr. 30
speciale

Klajdi Marku: ...Kur aktori në një moment mund ta ndjejë veten pak ligsht, ky publik të jep dadhuri, të jep ngrohtësi. Është publik që të ndjek vazhdimisht dhe unë e quaj si komponent të tretë të shfaqjes...

NATA E GJASHTË



Vënia e rregullit në botë është e pamundur

Në mbrëmjen e gjashtë të Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2008", para publikut dibran u paraqit Teatri "Aleksandër Mojsiu" nga Durrësi me tragjikomedinë "Tango" të autorit Slavomir Mrozhek, me regji të Driada Dervishit.

Aktorët Nik Xhelilaj, Xhelal Tafaj, Husen Bashhysa, Sanie Hoti, Eralda Çaushi, Marvin Tafaj dhe Ajshe Stani, artiste e merituar dëshmuan përkryerje të interpretimit aktoresk.

Driada Dervishi, regjisore, u shpreh se: "Artistët e mi i kryen me sukses rolet e tyre skenike. Ishin të impenjuar, që ka qenë një predispozitë dhe përgjegjësi përpara publiku.

Mesazhi i kësaj shfaqje, tha ajo: "Tregon se jetojmë në një botë me shthurje, marrëdhënie të ngatërruara e rrëmujë, ku tashmë personazhi kryesor kërkon pikërisht mënyrat që të vendos rregullin. Por për të vënë sot rregullin në botë është e pamundur".

Dhe pikërisht ngjarja flet për një djalë të ri idealist, i cili dëshiron të vendos rregullin.Ai jeton në një familje ku gjithçka është e shthurur, dhe përkundër dëshirës së tij të flaktë idealiste për ndryshime, e ka të pamundur ta realizojë qëllimin e tij.Vetë Fakti se shfaqja mbyllet me një tango bunt që kërcehet nga Eugjeni që përfaqëson traditën dhe kohën e shkuar, dhe nga pragmatisti Edi që përfaqëson të ardhmen, tregon pikërisht këtë. Me që tani s'ka idealizëm duhet gjetur një rrugë të mesme për të jetuar, sepse në botë methithatë njerëzit duhet të vazhdojnë të jetojnë".

NATA E SHTATË

Tragjikomia angleze në skenën dibrane

Në ditë e shtatë të Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2008, në skenë u paraqit Teatri Kombëtar i Gjakovës, me tragjikominë "Hiqe ministrin nga priza" të autorit Erik Ilde me regji të Ilir Bokshit.

Aktorët Arta Muqaj, Myrvete Kurtishi, Ernest Malazogu, Gresa Pallaska, Hysen Binaku, Ylber Bardhi, Arben Lleshi dhe Behar Zenelaj, u dhuruan shikuesve mundësinë e përjetimit të kënaqësisë skenike. Ata u gjendën mirë dhe bënë aktrim të mirë edhe pse kjo shfaqje kërkon një skenë me dimensione më të mëdha.

Ilir Bokshi, regjisor, tha pas shfaqjes se: " Kjo është komedi tipike angleze e cila përmban në vete të gjitha nuancat që e shkaktojnë komedinë në Angli.Kjo është edhe temë politike, sepse flitet për çështje politike të qarqeve angleze, por që lehtë na prekin edhe neve shqiptarëve si komb politizimet politike që i bëjmë në ditët e sotme. Këto janë ambicjet dhe apetitet që na rriten për poste, e kudërta e kësaj që ndosh pas humbjeve, pas dëshprimeve që u ndodhin politikanëve në jetë, kryesisht njerëzve që nuk janë të përgatitur në jetë dhe që u ndodhin dështime të këtilla".

Ngjarja paraqet një zv/ kryeministër të Anglisë, i cili për shkak të një aksidenti mbahet gjallë në një aparaturë, për shkak të numërimit të votave, përkatësisht të numërimit të votave të tij që diçka do të ndryshonte në parlamentin e Anglisë. Kur duan ta heqin nga priza, ta mbysin, kuptohet se kryeministri ivërtetë ka vdekur, por mundohen ta mbajnë edhe pak gjallë derisa t'i kryejnë tërë kombinimet konfliktuoze, për ta trashëguar postin zv/kryeministri që tashmë është duke e kryer detyrën"



Ademi dhe Fida duke e përgëzuar regjisorin Ilir Bokshi

REGJISORET VLERËSOJNË PUBLIKUN:

KLAJDI MARKU: "Të gjithë kemi një emocion të përbashkët, jeni publiku më i mrekullueshëm në tërë Shqipërinë.

ADEM KARAGA: "Dibra din të krijojë emocionin e vet. Ky publik është i mrekullueshëmm, përshëndes tërë aktorët për punën dhe kontributin e dhënë ".

YLBER NUREDINI: "Ky festival tregoi se ka një traditë. Gëzimi ynë është që teatri shqiptar vitet e fundit ka ecur përpara. Me punën e autorëve, aktorëve dhe regjisorëve ka mbëritur që një gjeneratë e re aktorësh të ketë vlera për t'ia prezentuar Evropës dhe për të marë shpërblime edhe në skenat evropiane. Ky është publik i përzemërt që i bën artistët të ndjehen lirshëm.

ILIR BOKSHI: Falenderoj shumë publikun dibran për ndjekjen me vëmendje të kësaj shfaqje dhe se është ndjenjë e posaçme të lozësh para këtij publiku të mrekullueshëm"

ZIJADIN MURTEZI: Me publikun dibran jam që në vitin 1972. Kam shëtitur Suedinë, Norvegjinë, Gjermaninë, kam marë pjesë në shumë festivale e festivale dhe kam marë shumë shpërblime, por kur i kthehesh vetvetes, e të gjitha i ke pranë teje duke filluar nga arti, kombëtarja, autori, aktorët, nuk ekziston kënaqësi më e madhe kur gjendesh mes publikun dibran që dallohet shumë nga të tjerët.

ROLAND MINGA: Nëqoftëse në pjesën e parë të shfaqjeve dhe në fillim të premierës shfaqja ishte në momentet konsolidimit të karaktereve , në shfaqjet e tanishme neve kemi tentur që personazhet t'i fusim midis qytetarëve. Publikun dibran tani kemi filluar ta shijojmë ne protagonistët e skenës, dhe publiku dibran këtë na e kthen me kënaqësi dhe duartokitje. Kam përshtypjen se në këtë gjë publiku dibran është i veçantë"

DRIADA DERVISHI: "Artistët e mi i kryen me sukses rolet e tyre skenike. Ishin të impenjuar, që ka qenë një predispozitë dhe përgjegjësi përpara publiku.

GENT BEJKO: Publiku dibran ishte fantastik dhe kjo u vërejt edhe nga pritja dhe përjetimi që i bënë shfaqjes dhe aktorëve të saj.

KLAJDI MARKU:
Aktorët sonte arritën majat. Kjo shfaqje është luajtur disa herë në Shqipëri në Vlorë, Fier e gjetiu, por këtu të gjithë kishim një emocion të veçantë, sepse luanim për herë të parë para publikut dibran... Kjo është hera e tretë që po vij në këtë festival. Kësaj radhe në rolin e anëtarit të jurisë dhe si aktor por jashtë konkurimit. Deri tani mendoja se publiku i Fierit është publiku më i mirë. Sonte është hera e parë që unë luaj para publikut dibran, dhe me sinqeritet e shumë emocion them se publiku numër një mes shqiptarëve është ai dibran, sepse kam qenë në të gjitha skenat shqiptare ku kam luajtur, me plot bindje them si publikun dibran është vështirë që të gjesh. Publik që edhe kur aktori në një moment mund ta ndjejë veten pak ligsht, ky publik të jep dadhuri, të jep ngrohtësi. Është publik që të ndjek vazhdimisht dhe unë e quaj si komponent të tretë të shfaqjes".

TRUPA E FIERIT, SHFAQJE JASHTE KONKURIMIT

"Kush më ka faj se jam shqiptar"

Në ditën e katërt festivalit në ora 18, para artdashësve, jashtë konkurimit u paraqit Teatri "Bylys" nga Fieri me dramën "Kush më ka faj se jam shqiptar", të autorit dhe regjisorit Enver Petrovci.

Aktorët Klajdi Marku në rolin e maestros, Bledar Mehmeti në rolin e Selmanit, Fatmir Xhelili në rolin e pijanecit (profesorit) dhe Olta Gixhari në rolin e Razës, dëshmuan një kompaktësi harmonike në interpretimin tejet të suksesshëm të roleve në skenë.

Klajdi Marku, në funksion edhe të regjisorit tha pas shfaqjes se "Ka ardhur koha që patriotizmi të mos jetë si një tabu falso, por të jetë me të vërtetë i mbështetur në prova, në emër dhe me dashurinë e vërtetë për vendin tone. Ky është edhe mesazhi i kësaj drame.

Fabula e kësaj pjese paraqet një autobiografi, nëse mund ta quajmë kështu. Eshtë jeta e një intelektuali në trojet shqiptare, por edhe e intelektualëve shqiptarë që kapën rrugën e mërgimit, e disa që u kthyen nga mërgimi, apo nuk shkuan fare atje. Gjithnjë duke luftuar me vetveten për të qenë edhe artistë të mëdhenj edhe shqiptarë të mirë, e atyre që patriotizmin se bënë biznes, e atyre që e humbën karierën, por fituan në konceptin njeri, apo të kundërtën e saj".

Për nivelin e realizimit skenik të aktorëve, Marku shprehet se: "Aktorët sonte arritën majat. Kjo shfaqje është luajtur disa herë në Shqipëri në Vlorë, Fier e gjetiu, por këtu të gjithë kishim një emocion të veçantë, sepse luanim për herë të parë para publikut dibran. Dhe ky ishte një kontakt i parë me diçka që e dashuron e respekton. Ne filluam me shumë emocione pozitive dhe them se publiku na vlerësoi si duhet".

Sa i takon publikut dibran, ai thotë se: "Kjo është hera e tretë që po vij në këtë festival. Kësaj radhe në rolin e anëtarit të jurisë dhe si aktor por jashtë konkurimit. Deri tani mendoja se publiku i Fierit është publiku më i mirë. Sonte është hera e parë që unë luaj para publikut dibran, dhe me sinqeritet e shumë emocion them se publiku numër një mes shqiptarëve është ai dibran, sepse kam qenë në të gjitha skenat shqiptare ku kam luajtur, me plot bindje them si publikun dibran është vështirë që të gjesh. Publik që edhe kur aktori në një moment mund ta ndjejë veten pak ligsht, ky publik të jep dadhuri, të jep ngrohtësi. Është publik që të ndjek vazhdimisht dhe unë e quaj si komponent të tretë të shfaqjes".



Materialet e speciales mbi festivalin u përgatitën nga Rexhep Torte

histori

Në kuadrin e 95-vjetorit të masakrave serbe në Dibër, historiani Moisi Murra na sjell një histori të shkurtër e të dokumentuar, për të na rikujtuar se historia nuk mund të harrohet pavarësisht politikave globalizuese, të mirëkuptimit dhe paqes

Masakrat serbe të vitit 1913



Nga:
MOISI MURRA

(Vijon nga numri i kaluar)

Për masakrat serbe të vitit 1913 është shkruajtur dhe do të shkruhet. Zor se shekujt do ta mbulojnë me pluhurin e harresës atë gjak të pafajshëm shqiptari që rrodhi nga bajonetat e pista serbe. Zor se kujtimi i hidhur do të arratiset nga truri i brezave.

"Në vend që t'i fshihnin veprat e tyre, ata përkundrazi mburreshin me ta. Një oficer serb edhe për pak sa nuk u mbyt mbi kupën e birrës nga të qeshurit, - shkruante publicistja E. Durham, - kur më rrëfente se qysh ushtarët e tij kishin shkuar në bajonetë gratë dhe fëmijët e Lumës" [1].

Qeveria mbretërore e Karagjergjoviçëve e kishte helmuar e nxitur ndërgjegjen e ushtarit serb me njëmijë e njëqind forma e mënyra për krime e masakra ndaj popullsisë së pafajshme shqiptare.

Në qafën e ushtarit serb në formë urdhri varej dekorata mbretërore me mbishkrimin: "OSvenqeno Kosovo" (Hakmarrje Kosovës) në njërën anë dhe në anën tjetër shënoheshin qendrat kryesore për pushtimin: .... Shkodër, Durrës, Prishtinë, Prizren, Kumanovë, Shkup, Dibër, Ohër, Elbasan etj. [2].

Domosdo ky urdhër për pushtim do të haste në një qëndresë që do t'i kushtonte politikës së qeverisë të N. Pashiqit. "Politika e qeverisë sonë ndaj Shqipërisë përfundoi me disfatë që na kushtoi viktima të mëdha..." [3] shkruante D. Tuçoviçi. Në Pocest të Maqellarës një vajzë 5 vjeçe e uritur qante për bukë. Një oficer serb pasi merr vesh se ç'kërkonte kjo foshnje, vendosi në majën e bajonetës një copë bukë e duke ia drejtuar vjazës ia kalon bajonetën në gojë e stomak përpara prindërve e banorëve të tjerë të fshatit [24]. Në Vojnikë dhe Allajbegi disa gra i përdhunuan dhe më pas i dogjën të gjalla [25].

> "... Këtu po bëhen gjëra të tmerrshme. Jam i tmerruar dhe pyes gjithnjë njerëzit mund të jenë kaq barbarë për të kryer të tilla mizori... Nuk ka veçse kufoma, pluhur dhe hi..."
>
> *Nga pohimet e një oficeri serb dhënë gazetës serbe "Radniçki Novine". Nr. 223, 22 tetor 1913.*

"Në vjeshtën e vitit 1913, - kujton Sherif Laçi – ushtria serbe duke kaluar nëpër Vlashaj rrëmbyen shtatë burra të cilët u morën me vete deri në Qafë-Mërkurth (Mirditë). Aty i lidhën me litar pas aheve pastaj me bajonetë i vrasin duke i lënë bajonetat të përshkruar nga trupi në ah [26].

Në shkallë të Klenjës serbët zunë dhe pushkatuan njëherësh 30 vetë duke i groposur në një vend të gjithë.

Shumë nëna hidhnin rrugës edhe foshnjet që kishin për gjiri nga tmerri i armikut. Shumë pleq e plaka vdiqën rrugës nga se nuk kishin fuqi të ecnin. Nëna hidhte fëmijën, fëmija prindin e kështu shumë njerëz u bënë dhe viktima të ujqërve nëpër male [27].

Në fakt masakrat serbe kishin filluar në viset shqiptare të okupuara që muajt e parë të vitit 1913.

Gazetat shqiptare e të huaja çdo ditë nxirrnin në faqet e tyre barbarit serbe.

Pashoqi për të përligjur këto krime të përbindshme i shkruante Radomir Putnikut më 4 shkurt 1913 që të thirreshin përfaqësues të shtypit evropian dhe të punohej me ta për të kundërtën e fakteve. Por komandanti suprem i ushtrisë jugosllave R. Putniku që e dinte se ç'masakra kishin kryer ushtarët e tij e kundërshtonte prerë kryeministrin Pashiq: "S'jam i mendimit të lejohen përfaqësues evropian që në kohë lufte të dalin në vendin e ngjarjes" [28].

Kjo tabllo do të përsëritej dhe 68 vjet më vonë me gazetarët e huaj në ngjarjet e Kosovës. "Lëshoni Evropën të gjurmojë dhe të gjykojë", shkruante gazeta "Rajhpost". Dhe këtë e bënte një ushtarak i lartë serb në një letër dhënë gazetës socialiste serbe "Radniçke Novine": "Nuk kam kohë të shkruaj gjatë, por mund të them se këtu po bëhen gjëra të tmerrshme. Jam i tmerruar dhe pyes gjithnjë se si njerëzit mund të jenë kaq barbarë për të kryer të tilla mizori... Nuk ka veçse kufoma, pluhur dhe hi" [29].

Gazeta italiane "Il'sole" e 28 nëntori 1913 duke publikuar interesat politike të moderuar të qeverisë së saj në Shqipëri dënonte barbaritë çnjerëzore serbe kur shkruante se "serbët dhe malazezët kanë zgjedhur mënyrën e kundërt nga ajo që përdorim ne për të depërtuar në Shqipëri, ne e ndihmojmë elementin indogjen, kurse ata e asgjësojnë" [30].

Dhe me të vërtetë. Vetëm gjindarmi Aleksandër theri me dorën e vetë 19 njerëz të pafajshëm në qytetin e Dibrës së Madhe [31], shkruante H. Stërmilli.

Barbarizma dhe vetëm barbarizma. "Kudo që shkeli ushtria serbe u dha tmerrin vendasve..." [32].

Gazeta italiane "Corriere della Puglie", gazetat shqiptare "Përlindja e Shqypënies", "Liria e Shqipërisë", "Kalendari kombiar" botuan nëpër faqet e tyre masakrat serbe në Dibër. Masakra me gjithë mend të padëgjuara e tronditëse. U kthyen në gërmadha 80 fshatra, u dogjën, shkrumb e hi 1517 shtëpi. U vranë, u therën apo u hodhën të gjallë në zjarr 2554 burra e gra e shumica fëmijë nën moshën 12 vjeç. U rrëmbyen mbi 2700 bagëti të trasha, 800 njëthundrakë, 21.000 bagëti të imta dhe 1 milin e 580 mijë lira turke.

Mbi 100.000 frymë gra, burra e çiliminj" [33]. Sipas H. Stërmillit dhe "200.000 vetë" sipas Pollonz zv. konsulli austrohungarez në Durrës, - njerëz që kanë një ndërgjegje kombëtare (të pastër M. M.) dhe që duan të bashkohen me vëllezërit e tyre, po e kalojnë në mjerim të madh jetën e tyre në këtë pjesë të Shqipërisë (Elbasan, Durrës, Tiranë – M. M.) duke pas lënë në vend (në Dibër – M. M.) pasurinë e tyre me miliona vleftë [34].

"Dy kortezhe të gjata – Dibër-Elbasan dhe Dibër-Tiranë – e përcollën lirinë në robni... Klithma e fëmijëve dhe gjama e grave që përbënin një pamje infermale të asaj nate dy herë të zezë, përziheshin me krismën e pushkëve e bubullimën e topave... Ky ishte marshi funeral i Dibrës së varrueme në robni, ishte vaji i zemrave të plasura e të përvëlueme për lirinë..." [35], shkruan Haki Stërmilli.

Katunde e qytete binin erë gjak njerëzish. Tym e flakë shkrumbonte Dibra që ishte kthyer në një Trojë-gërmadhë, por jo për zemërim të Akilit, por për hegjemonizëm e ekspanizionizëm të Serbisë së Madhe të Stefan Dushanit.

"... Kojnara, Sollokiçi, Spasi, Allajbegia, Bllata, Reshani, Majtara, Çernena, Vojnika, Kllobçishti... Në Rekë: Tërnicë, Nistrovë, Jançe, Radostush, Haxhiafce, Kosovraç, Skudrinë, Prisojnicë... Në Gollobordë: Zabzun, Klenjë, Steblevë, Borovë, Sebisht, Ostren, Okshtun..." [36] kishin humbur plotësisht trajtat e fshatrave. Shkrumb e hi ishin bërë dhe fshatrat: Tërbaç, Viçisht, Golovishtë, Izvir, Gjoricë, Kovashicë, Çerenec, Bllacë e Sipërme dhe e Poshtme, Izvir, Gjoricë, Kovashicë, Çerenec, Bllacë e Sipërme dhe e Poshtme, Mallakastër, Shupenzë, Boçevë, Homesh, Zogje, Okshatinë, Topojan, Shtushaj, Mazhicë, Sepetovë, Vlashaj [37], gjithë krahina e Zerqanit, Bulqizës, Selishtës, Dibrës, Poshtme, Kalaja e Dodës – gërmadhë gjithë Dibra brenda dhe jashtë kufijve politikë të vitit 1913.

Natyrisht këto masakra ndeshën në një qëndresë të jashtëzakonshme të dibranëve.

Zv. konsulli austrohungarez në Durrës, Pollonz, në një raport dhënë ministrisë së punëve të jashtme të monarkisë dualiste shkruante: "Ndërsa burrat me duar të lidhura i prunë në sheshin përpara fshatit (Topojan – M. M.) për t'i vrarë ose për t'i masakruar, u dëgjua ankimi i një gruaje: "Unë isha me burrin tim në mal për dru. Na erdhën dy ushtarë serbë të cilët rrahën burrin tim dhe mua më keqpërdorën. Burri im që u ngrit prej të rrahurve, pati fatin që me një thikë xhepi t'i priste gurmazin njërit ushtar dhe me pushkën e këtij të vriste ushtarin tjetër... Serbët janë horra të liq... Sulmini serbët" [38].

REFERENCAT

19) Masar Rizavnolli, Gjurmime albanologjike, seria e shkencave historike, Prishtinë, 2-1992, f. 131.
20) Qeveria e Përkohshme e Vlorës, Tiranë 1963, dokument 275, f. 201.
21) Limon Rushiti, revista "Jehona", 6/1993, f. 101.
22) Edi Durham, njëzet vjet ngatërresa ballkanike, Tiranë, 1990, f. 391.
23) Shaban Braho, Idriz Seferi, Tiranë, 1981, f. 191.
24) Dimitri Tuçoviç, Serbia dhe Shqipnia, Tiranë, 192 b, f. 97.
25) D. Uruçi, Pocest-Maqellarë, vjeç 90, informacion gojor i vitit 1983.
26) Sherif Laçi, Gur-Reç, vjeç 95, informacion gojor, viti 1983
27) Haki Stërmilli, vepër e cituar, f. 83.
28) Shaban Braho, Idriz Seferi, Tiranë, 1981, f. 204.
29) Ajet Haxhiu, Hasan Prishtina, Tiranë 1968, f. 116.
30) Gazeta "Il Sole", 28. IX. 1913, nr. 2054
31) H. Stërmilli, vepër e cituar, f. 80-81.
32) Gazeta "Liria e Shqipërisë" Sofje, 8.03.1913, f. 2.
33) H. Stërmilli, vepër e cituar, f. 95.
34) Instituti i Historisë i R. SH. Fondi i Arkivit të Vjenës, nr. 23-17.1743 dhe shtojca e raportit nr. 1/259, dt. 10 tetor 1913.
35) H. Stërmilli, vepër e cituar, f. 95.
36) Gazeta "Liria e Shqipërisë", Sofje, 30 vjeshtë II-të 1913.
37) Po aty, 28 vjeshtë e I-rë, 1913.
38) Instituti i Historisë i RSH, Fondi i Arkivit të Vjenës. Raport i konsullit austriak në Durrës, Pollanz, dërguar Vjenë, më 10 tetor 1913.

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

duke u pajtuar dhe duke bashkëpunuar

gazeta hap faqet e saj për të rinjtë e shkollave,
kryesisht për ata që pretendojnë të fillojnë rrugën e gazetarisë,
duke krijuar hapsira të posaçme për krijimet e tyre
letrare e publicistike...


Shkruaj dhe ti mendimin tënd!

www.dibra.org

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

Prof. Dr. Hajri Shehu sjell një studim praktik për mjetet e informimit të publikut, mbi standardet e gjuhës së shkruar dhe të folur shqipe. Të gjithë shembujt e dhënë në shkrimin e mëposhtëm janë marrë nga televizionet, radiot e gazetat e Tiranës.

Për **pastërtinë e gjuhës** së mjeteve të sotme të **informimit masiv**



Nga:
Prof. dr. Hajri SHEHU



Mjetet e informimit masiv mund të ruajnë veten, por mund të ruajnë edhe të tjerët.

Është fakt i njohur e shumë domethënës që në mjetet tona të informimit masiv ka shkrime e kumtime mjaft të mira edhe në punë të gjuhës e veçanërisht, të zgjedhjes së fjalës. Por ka edhe shkrime e kumtime, ku përdoren shumë fjalë të huaja të panevojshme, sidomos anglicizma, ose formime nga fjalë të huaja, gjithashtu, të panevojshme, për të thënë edhe gjëra fare të zakonshme e kur shqipja i ka mjetet e saj të shprehjes.

Huazimet e panevojshme (më së shumti, anglicizma) në mjetet e informimit masiv janë kryesisht fjalë që nuk i kërkon as ligjërimi i ngritur (tipi **implementimi** *i ligjit, opozita* **kontestoi** etj.), as ligjërimi i përditshëm (shih, p.sh. që për të na mësuar si lahen petkat, në reklamë dëgjohet: *mënyrë e larjes* **perfekte;** për tullat: *tulla me cilësi* **perfekte**; kurse në një lajm për koshat e plehrave thuhet: **inekzistenca** *e koshave të plehrave,* dhe për karnavalet: *nuk kanë* **resurse** *për karnavalet*; për pirjen e duhanit, ajrin dhe mbeturinat na thuhet: *në këtë* **prevalencë** *të duhanpirjes;* **turbulencat** *e ajrit; për* **evadimin** *e mbetjeve urbane*), ose janë fjalë krejt rastësore, pa asnjë vlerë stilistikore (**luku** *i saj tërheqës*; *ligji i luftës është një* **nonsens**; *mori pjesë edhe* **first-leidy** etj.). Në skedarin tonë kemi shumë shembuj të përdorimit të fjalëve të huaja të panevojshme a me prejardhje të huaj, gjithashtu, të panevojshme; do të përmendim vetëm disa: a *afektohet* publiku nga …; përshëndeti *akordet* e politikës; nuk përpiqen ta *akseptojnë;* të krijojë *aksese*; fond i *alokuar;* kronikë e *anoncuar; apdejtimi* i strategjisë*;* qeveria do të *asistohet;* treg *atraktiv;* programe *çertifikimi*; problemet që *derivojnë;* do të *definohen;* jo të gjithë lojtarët janë *të disponueshëm*; *drafti* ka nisur *të ekzekutohet*; qyteti është *dekoruar* me lule; *editorialistja* e gazetës; do t'i japim *ekstension;* këto *facilitete;* cilat janë ato *handikape; impakt i absorbueshëm*; *induktim* intensiv në mendjet e njerëzve…; *investigon aferat;* raport *investigativ;* nuk do të jetë vetëm një *shou,* por edhe një *kompeticion;* politika *kontraverse;* biznesmen *i kontraversit;* me buzëqeshje *kordiale;* masa *obligative; performanca* e qeverisë; grupet e fëmijëve kanë *performuar; performuese* e dy *zhanreve*; praktika *perverse;* realizon *produksione; promocion* agresiv; ofertë *promocionale;* në mënyrë *promocionale;* palestra *rekreative;* për t'i bërë ballë *riskut potencial; promovohet* libri …; të *promovojë* shtete; iu *fokusua* biznesit; a është në *recesion* ekonomia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës; ministrat ranë *dakord*; duke *injektuar* fonde; politikë e *suportuar; terma* (= kushte) konkretë të kontratës; ndjekin një *trend* pozitiv etj.

Është e habitshme të vëresh se si fjalë të huaja, më së shumti, anglicizma zëvendësojnë fjalë a formime shqipe me jetë të qëndrueshme në gjuhë jo vetëm në ligjërimin libror, por edhe në ligjërimin bisedor, të përditshëm. *Mendësi* e viteve '30 të shekullit të kaluar (shih gazetën "Drita" të atyre viteve) zëvendësohet me *mentalitet, kryeqyteti / kryeqendra* me *metropol, bërthamor* me *nuklear, cilësi* me *kualitet, bashkim* me *union* (në parantezë: *union* është në zanafillë dysor me *onion = qepë*), *mirë* (shkodranët kanë edhe *mirakandas)* me *okei* (me prejardhje të paqartë edhe në vetë gjuhën angleze) etj. Kostandin Kristoforidhi, që më 1904 ka në jetën dhe në Fjalorin e tij fjalën *ndërgjegje* (si gjuhëtar, por ndoshta, edhe për mbushamendjen tonë, jep në kllapa motivimin fjalëformues shqip: *ndër-gjegjem),* kurse sot, ka deputetë e politikanë që e zëvendësojnë pa të keq me fjalën e huaj *koshiencë;* kurse mbiemrin *koshient* e përdorin edhe më shpesh se emrin *koshiencë.* Mundet që nën ndikimin e anglishtes, *Ministria e Arsimit* të bëhet *Ministria e Edukimit* dhe *kafeja më e mirë* të shkojë më tej se *top kafe* e të bëhet *tip- top kafé (!).*

Në parantezë: Përmendëm deputetë e politikanë. Po, sepse kur flitet për mjetet e informimit masiv, kemi parasysh edhe gjuhën e shkruar – gazetat, lajmet, filmat televizivë e programet e tjera të televizioneve e të radiove, që *parapërgatiten*, edhe gjuhën e folur – konferencat e shtypit, intervistat, takimet e bisedat politike etj. të deputetëve, të politikanëve etj. që *nuk parapërgatiten*. Por, *edhe pse e paparapërgatitur,* gjuha e folur është formë e gjuhës, e normativizuar dhe e lëvruar deri në kufijtë e gjuhës së shkruar, domethënë, edhe në një bisedë, intervistë, fjalim etj. deputeti, politikani, folësi (kushdo qoftë ai) domosdo duhet të orientohet nga normat e gjuhës së shkruar. Prandaj, edhe gjuha e folur nuk është e nuk mund të jetë më pak standarde se gjuha e shkruar. Veç të tjerash, edhe për arsye jashtëgjuhësore. E, fjalët e huaja të panevojshme, siç do të mundohemi ta argumentojmë më tej, janë thyerje e standardit.

Sidoqë më pak, në mjetet e informimit masiv ka edhe huazime të panevojshme kuptimore e përkthimore. Këto e dëmtojnë më shumë ligjërimin sepse sjellin krejt mekanikisht mënyra të huaja të menduari dhe përkthimi. Shihni shembujt e mëposhtëm: *prodhon* afera/ *prodhon* pasoja / kjo situatë *prodhon* / të *prodhojë* festë / gruaja të *prodhojë* politikë / mund të *prodhojë* atmosferë konflikti potencial / *prodhon* art kualitativ / *prodhon* stabilitet; bashkësia ndërkombëtare e *ka mbledhur* më në fund *guximin* për …; *do të vuajmë* mungesa; pedagogë të *rekrutuar* për këto universitete; opozita: po punojmë për *rekrutime* të reja; të bëhet më tepër *i konsiderueshëm;* ne *konsiderojmë …/* Banka është duke *konsideruar* (zanafilla e fjalës në gjuhën nga ka ardhur, është astrologjia); personeli *operacional* (është fjala për fluturime me aeroplan); të *vihet në operim; oficerët* tanë të kredisë, *grupet e interesit; të vijë në shprehje (ky opsion mund të vijë në shprehje); produkti* i bisedimeve etj. Ata e ato që dinë gjuhë të huaja, sidomos anglisht, nuk e kanë aspak të vështirë të gjejnë prejardhjen e drejtpërdrejtë të këtyre fjalëve, shprehjeve a përkthimeve.

Jo fare rrallë, fjalë të huaja ose me prejardhje të huaj, të ligjërimit të atjeshëm bisedor, të përditshëm ngjiten krejt pa nevojë deri në ligjërimin libror: *ligji pret* **okein**. Fatkeqësisht, edhe turqizmi *zahire,* një fjalë e ligjërimit të përditshëm, bisedor, sidomos fshatarak, na qe ngjitur lart e lart e qe bërë emërtim i një emisioni të përjavshëm në një televizion. Se ç'lidhje ka *zahireja* (domethënë, ushqimet që përgatiten e vihen mënjanë për dimër, ose si e thotë populli me fjalën joturke "tërëmotje") me opinione e opinionistë nuk e gjejmë dot.

Ka edhe më keq: fjala e huaj ose formimi sipas fjalës së huaj përdoret krahas fjalës shqipe a formimit shqip me një *dhe* ose pa *dhe,* duke i barazuar (!) kështu *(detyrimet* dhe **obligimet**; *helmime* dhe **intoksikime**; ata që **proklamuan**, *që shpallën;* një *eskalim;* një *përshkallëzim;* **demontim** ose *çmontim* etj.), ose edhe më keq se kaq: fjala e huaj përdoret për të sqaruar (që *të qetësohesh,* që të *relaksohesh*; nga *sforcimi fizik* ose **efforti** // nënvizimi me të zezë është yni – H.Sh.).

A ka arsye për ardhjen e fjalëve të huaja? Sigurisht, ka. Fjalët e huaja vijnë ngaqë janë futur e futen dije e shkenca të panjohura më parë, si, mënyra e prodhimit dhe e tregtimit kapitalist, financa kapitaliste, informatika etj. dhe, siç dihet, fjala mund të hyjë bashkë me sendin a me dukurinë. Ndikimi politik, ekonomik, ushtarak, shkencor, kulturor etj. i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sidomos në vitet '90 e këtej ka sjellë rrjedhimisht edhe ndikimin e anglishtes, nga ku edhe vijnë më së shumti, fjalë të huaja.

Ndër arsyet subjektive (kur themi arsye subjektive, kemi parasysh përdorimin pa vend e pa nevojë të fjalëve të huaja, sidomos angleze) mund të përveçoheshin: formimi i pamjaftueshëm gjuhësor i aksh gazetari, redaktori, politikani etj. e njohja e pamjaftueshme e kulturës së gjuhës. Të njohësh kulturën e gjuhës, ta zotërosh e ta zbatosh kulturën e gjuhës, nuk do të thotë të njohësh, të zotërosh e të zbatosh vetëm normat gramatikore, drejtshqiptimore e drejtshkrimore, por edhe normën fjalësore (leksikore) e stilistikore, pra ta zgjedhësh e ta përzgjedhësh fjalën, shprehjen etj. për thënien tënde. Po japim një shembull. Nga pikëpamja gramatikore, fjalët *barrierë, indikator, insistencë (insistenca e komisioneve), i limituar (mundësitë e limituara të pushtetit vendor), preliminar (rezultatet preliminare), afektoj (kanë afektuar ekonominë)* tingëllojnë të rregullta - janë emra, mbiemra e folje, siç mund të ishin *pengesë, tregues, këmbëngulje (ngulmim), i kufizuar, paraprak, prek,* por ato nuk janë të rregullta nga pikëpamja e normës leksikore (fjalësore) e stilistikore, sepse janë fjalë të huaja, krejt të pazgjedhura e krejt të panevojshme ngaqë kemi fjalët shqipe (shih më sipër fjalët e radhës së dytë), pra janë barbarizma. Mbase, në një rast të tillë, Shteti mund të fliste, siç ka folur Shteti i Pavarësisë: "*Të gjithë ta dinë mirë se në ditën fatbardhë që Shqipëria dolli më vehte, gjuha shqipe u bë gjuha zyrtare e vendit. Tani çdo degë e administratës duhet të ketë nëpunës që ta njohin mirë gjuhën me gojë, me shkrim e këndim…* **Edhe nëpunësit që janë në shërbim, do të japin provim në gjuhën shqipe. Të zotët do të konfirmohen, të tjerët për një kohë të mësojnë, po qe se duan të mbeten në shërbim**". ("*Përlindja"*, 30.08.1913) (Nënvizimi është yni – H.Sh.). Ndoshta (besojmë të jenë arsye shoqërore të përkohshme), edhe njëfarë qëndrimi kozmopolit a prirja intelektualiste për t'u dukur i ditur e i mësuar para të tjerëve (*e* **kondicionontе** *daljen e të burgosurve...; sipas një* **investigimi…;** *masa* **represive…;** *përpjekje për* **të interferuar;** *ka* **gjeneruar** *rritjen; nga* **persekucioni…**; **evidencë** *historike; politika* **fiskale** / zotëria nuk thotë dot (!): e *kushtëzonte ..., sipas një hetimi, masa shtypëse, përpjekje për të ndërhyrë, ka sjellë rritjen, përndjekje (*por as *persekutim), dëshmi historike, politika tatimore)* e edhe kryemëvetja e ndonjë shkruesi, folësi etj. (nuk shkëputet dot i gjori njeri (!) nga: *implementimi (implementimi i një politike…), impakti (impakti i kërkimit...* e *emocione impakti), aksesi (ka akses* e *nuk ka akses), alokoj (alokoj fonde* e *fondi i alokuar), afera korruptive, monitorim (për monitorimin e situatës), opsion (nuk është opsion ndarja...)* etj. etj.). Ndoshta, edhe njëfarë shkujdesjeje a pakujdesie se ndryshe nuk mund të na zinte veshi fjalën *transnacional* për *internacional* a *ndërkombëtar*.

Një arsye subjektive madhore na duket se gjendet te roli i shtetit. Teorikisht, duket se shteti ka një politikë gjuhësore që u përgjigjet kërkesave objektive të zhvillimit, të pasurimit e të pastrimit të mëtejshëm të gjuhës shqipe standarde, përderisa Kushtetuta e Shqipërisë, me një nen të posaçëm merr në mbrojtje trashëgiminë kulturore dhe gjuhën kombëtare. Por, praktikisht, na duket sikur shteti ose nuk e ka autoritetin e duhur, ose nuk pyet për gjuhën, përderisa nuk e shohim ta institucionalizojë e as ta vlerësojë sadopak mendimin shkencor por edhe publik (ky i fundit ka dalë edhe me thirrje në shtyp) për ta ruajtur e çuar më tej pastërtinë e gjuhës sipas parimeve e kritereve shkencore, përderisa shteti e bën një sy qorr e një vesh shurdh për emërtime shitoresh e veprimtarish, për reklama e tabela (i shihni vetë, i nderuar lexues në qytet e sidomos, në televizione, të tilla, si *sponsor gjeneral, T. oil… kompania lider*), përderisa vetë veprimtaria shtetërore e pasqyruar në mjetet e informimit masiv e vetë botimet e shtetit lënë një shije jo fort të këndshme në punë të përdorimit të fjalëve të huaja.

(Vijon numrin e ardhshëm)

nderim

"Më shumë po na vret neglizhenca e shtetit,
ky indiferentizëm po na kushton shumë.
Jeta është e shtrenjtë në të gjitha vendet e botës

OPINION

Sa e lirë qenka jeta

Nga: **SHAQIR SKARRA**

Jetojmë në kohë paradoksesh që për botën perëndimore janë si diçka absurde. Çmimet po rriten dita ditës. Buka është rritur, fruta e perime po, ushqimore e veshmbathje gjithashtu. Po rriten të gjitha, karburante e transporti i udhëtarëve, varfëria dhe papunësia. Krimi në rritje, korrupsioni në rritje, inflacioni në rritje. Të gjitha në rritje, të gjitha, e këto ndodhin vetëm tek ne. Vdekshmëria foshnjore në rritje,shërbimi shëndetsor në rritje, shërbimi funeral që i bëhet njeriut të dashur për herë të fundit në rritje. Dhe flasin politikanët për rritje mirëqenje. Nuk di se ku është rritur mirëqënja e shqiptarëve kur listat e çmimeve kanë mbushur fletore të tëra në dyqanet e lagjeve e fshatrave. Sivjet ndodhi çudia e madhe ku fermerët mbollën misër e korrën kashtë. Për të qeshur e për të qarë njëherësh por ama dëmi që u solli kjo farë sterile që erdhi nga Franca është shumë i madh. Vërtet ne shqiptarët jetojmë kohë paradoksesh dhe pikërisht në një kohë që pretendojmë se do të integrohemi në Bashkimin Europian. Po ndodh me ne shqiptarët krejt e kundërta; jeta,jeta që është aq e shtrenjtë për të gjithë kushton fare pak, shumë lirë. Megjithëse jemi vend i vogël çdo ditë po ndodhin vdekje. Sa shumë vdekje ndodhin vërtet?.

Vdekje nga aksidentet, vdekje nga mjekët e papërgjegjshëm, vdekje nga gjakmarrja, vdekje nga sëmundjet e shumta, vdekje nga krimi që është ulur këmbëkryq e nuk do t'ia dijë për shtet e ligj.

Vrasje e vetvrasje po thuaj çdo ditë,e të gjitha këto në moshë të re, ditën me diell e në sy të shtetit.

Sa e lirë qenka jeta !.

Ndodh një aksident automobilistik që merr disa jetë njerëzish njëherësh. Pse? Shoferi ishte i dehur apo dhe me patentë fallco, apo dhe më keq, shoferi ishte nën moshë që të përgjigjej para ligjit.

Po kush përgjigjet para ligjit? Askush. Fajtor viktimat që ikën. Dhe ku ? Në mes të qytetit të zhurmshëm ku ka shumë lëvizje.

Në semafor ndodh aksidenti, në prezencë të policit të qarkullimit. Sa keq. Shoferi ikën në drejtim të paditur e polici që mban uniformën e shtetit është i pafuqishëm të ndalonte këtë aksident. Polici i pafuqishëm që të pengojë mjetet që qarkullojnë në korsitë që janë për autobuza. Dhe më e keqja se është vendosur një tabelë që tregon se kjo korsi është vetëm për autobuza. Po kush do t'ia dijë për këtë. Një ditë policët trembin me gjoba dhjetë shoferë e ditën tjetër kalojnë njëqind e më shumë pa e parë dhe dritën e ndezur dhe të semaforit. Shoferët sot nuk duan t'ia dinë as për policët e qarkullimit. Fundja ato nuk ndodhen gjithmonë aty ku i shikon syri i qytetarit dhe mund të ketë më shumë aksidente ditën me diell por janë më larg aty ku syri i askujt nuk i kap kur marrin nën dorë ndonjë lek, sa për kafen e mëngjezit. Vaj halli po të jetë ndonjë korsi për autoambulanca. Këtu më shumë kalojnë makina të tipeve të ndryshëm se sa autobuza. Polici hesht. Hesht edhe kur shikon makinat me shpejtësi në semafor, në trotuar, hesht edhe kur shikon makinat e shumta që parkohen në mes të rrugës e trafiku bllokohet me orë të tëra. Kemi një polici të qarkullimit rrugor por se ku ndodhen nuk e dimë. Vetëm në lëvizje i shikojmë kur në rrugë kalon eskorta e ndonjë titullari ku më tepër se një orë para janë pikërisht këto polic që bllokojnë rrugën. Një vajzë e re në moshë, në lulen e rinisë iku për një operacion të bërë gabimisht nga mjeku. Edhe pse vajza iku nga kjo botë, mjeku ende është i lirë, pa iu futur gjëmb në këmbë me një klinikë private jashtë çdo standardi që duhej të kishte.

Në Gërdec u vranë 26 jetë të pafajshme dhe ende nuk i është futur gjëmb në këmbë askujt. Një nënë bënte apel për djalin e saj shtatë vjeçarë që humbi jetën në Gërdec para mediave, tregonte dhe librat, rrobat, kukullat që mbante djali i saj . E kush e dëgjoi apelin e saj? Ish ministri dha dorëheqjen por prokuroria ende nuk e ka thënë fjalën e saj. Zërin e asaj nënës nga Gërdeci nuk ka kush ta dëgjojë. Askush nuk e ka dëgjuar zërin e tyre.

Askush. Tamam si tek aventurat e Odisesë. "Më vrau "askushi!"Vrasje dhe vetvrasje, vdekje nga sëmundjet e shumta që vijnë dhe nga smongu e ndotja e ambientit megjithëse kemi dhe një Ministri të Mjedisit, aksidente nga pakujdesia dhe neglizhenca e ligjit. E megjithatë vetëm heshtje. Kështu jemi dënuar ne shqiptarët.

Më shumë po na vret neglizhenca e shtetit,ky indiferentizëm po na kushton shumë. Jeta është e shtrenjtë në të gjitha vendet e botës. Tek ne krejt e kundërta po ndodh.

Çmimet rriten të gjitha dita ditës e jeta e jonë po kushton lirë. Vërtet sa e lirë kjo jeta jonë?

LETRAT E LEXUESVE

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për të pritur letrat e lexuesve për problemet dhe shqetësimet e tyre.

Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.

Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.

Tel: (04) 2233 283

Cel.068 31 19 232 / 069 20 68 603

E-mail: rrugaearberit@gmail.com

HOMAZHE

Ndahet nga jeta Bashkim Gazidede



Pasditen e 25 tetorit 2008 u nda nga jeta, pas një sëmundjeje të rëndë, Bashkim Gazidede, një nga personalitetet e shquara të jetës politike shqiptare, ish-pedagog i Fakultetit të Shkencave të Natyrës që nga viti 1984, ish-deputet i Partisë Demokratike në Parlamentin shqiptar në zgjedhjet e vitit 1992, Drejtor i Shërbimit Informativ Kombëtar në vitet 1992-1997, Nëndrejtor i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në vitet 2005-2008.

Bashkim Gazidede lindi në 2 shkurt 1952, studimet parauniversitare i kreu në rrethin e Peshkopisë me rezultate të shkëlqyera ndërsa studimet universtitare pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Dega Matematikë po me rezultate të shkëlqyera. Pas mbarimit, punoi mësues në Cidhën dhe Fushë Cidhën dhe më pas, që nga viti 1984 emërohet Pedagog pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

Bashkim Gazidede është autor i disa teksteve dhe monografive universitare dhe ka patur një karrierë brilante akademike.

Bashkim Gazidede ishte një nga ata intelektualë dibranë që u angazhuan që në orët dhe ditët e para në lëvizjen demokratike së bashku me pedagogë dhe studentë të tjerë të Universitetit të Tiranës. Ai dha një kontribut të vyer në përmbysjen e diktaturës komuniste në Shqipëri. Në zgjedhjet e 22 Marsit populli i Dibrës do ta zgjidhte si përfaqësues të denjë të parlamentit pluralist. Pak muaj më vonë atij do t'i ngarkohej detyra e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe drejtimin e këtij shërbimi.

Nga viti 2005 deri në vitin 2008 ai punoi me përkushtim të madh në reformën e sistemit të regjistrimit të pasurive.

Homazhet dhe ceremonia mortore, u organizua edhe nga Kuvendi i Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, në sallën e seancave plenare të Kuvendit, në prani të personaliteteve të larta shtetërore, familjarëve dhe miqve të tij.

"Bashkim Gazidede i përket asaj plejade të intelektualëve shqiptarë, të cilët në vitet '90 me guxim dhe kurajë të pashoqe shembën murin e Berlinit dhe themeluan në Shqipëri pluralizmin politik, njeri i një performance të shkëlqyer gjatë jetës së tij" tha kryeministri shqiptar Sali Berisha gjatë homazheve për nderim të tij. "Ndahet nga jeta duke lënë kujtimin e një intelektuali të shquar, e një shërbëtori të madh të kombit të tij, e simbolit të një njeriu të ndershëm, e një promotori të vërtetë të proceseve demokratike në Shqipëri", tha Berisha.

Me vdekjen e tij familja humbi njeriun e vet më të dashur, miqtë dhe të afërmit humbën njeriun të cilin do ta kujtojnë gjithmonë me respekt dhe dashuri

Gani Tonuzi, një jetë të tërë rrugëve të kurbetit, i tretur me mallin e dashurinë për Shqipërinë



Garfield - New Jersey : U mblodhën miq, shok, familjarë të ardhur këta nga të katër anët për t'i dhënë lamtumirën e fundit, të afërmit të tyre, patriotit dhe atdhetarit të dëshmuar Ganit Tonuzi, I cili vdiq pas një sëmundje të rëndë në moshën 83 vjeçare, më 4 tetor, 2008, në spitalin civil Hacknsack Hospital, Nju Xhersej.

Në orët e para të mëgjesit, në minutat e fundit të jeëts pranë trupit të tij në minutat e fundit të jetës u gjendën familja, gruaja e tij, dhe fëmijët Fatmiri, Drita, Besa, Violeta, Farija dhe Hana. Ganiu ishte 9-herë gjyshë, vëllai i katër vëllezërve të tjerë të njohur këta në komunitet si veprimtarë të çështjes kombëtare, Shehatin, Hajdarin, Bairamin dhe Hakiun.

Gani Tonuzi, ishte një njeri mjaft i dashur, fjalë ëmbël dhe i pakursyer, i përkushtuar për familjen dhe shoqërinë. Ai ishte një prej atyre i cili sakrifikoi jetën për të shpëtuar nga terrori komunist. I shtërguar nga rreziku për jetën e tij dhe të familjes në vjeshtë të vitit 1951, Ganiu nga katundi Allajbegaj merr përsipër të nxjerr përtej kufirit tre familje.

Por, kjo, rrugë nuk ishte fare e lehtë....

Kur shqiptarët që arratiseshin nga Shqipëria në Jugosllavi, Tito, në vitin 1956, hapi kampet famëkeqe ku keqëtrajtoheshin të arratisurit. Ganiu dhe familja e tij u trasferuan në malet e egra të Sërbisë, në Kardaçiç. Në këtë kamp, rrefejnë dëshimtarët , ishin rreth 1800 shqiptarë, shumica gra, fëmijë e pleq.

Në karatinën e ferrit sërbo - sllav, aty ku çdo i arratisur duhet të kalonte një vit e gjysmë i rrethuar nga telat me gjëmba, rrethuar nga ushtarët e armatosur gjern në "dhëmbë" dhe në punën e detyrueshme bëheshin planet e emigrantëve shqiptarë për të dalë në perëndim.

Fati e solli që Ganiun me gjithë anëtarët e tjerë të familjes e dërguan në Francë. Mbasi jetojë rreth 10 vjet në rrethinat e Parisit, erdhi dhe u bashkua me anëtarët e tjerë të familjes Tonuzi, në SHBA-së.

Ganiu së bashku me familje jetojë në SHBA deri në ditën e vdekjes.

Ai dhe familja e tij kishte ideale të pastërta kombëtare. Mendonte, luftonte e punonte gjithmonë për një Shqipëri të lirë, demokratike dhe jokomuniste. Për një Kosovë të pavarur e një Shqipëri Etnike.

Ai mundi të përjetojë dy gëzimet më të mëdha të kombit shqiptarë, rënjen e komunizmit në Shqipëri dhe lirinë e Shqipërisë, si dhe Pavarësinë e Kosovës, realizmin e ëndërrës shekullore të shqiptarëve.

Udhëtimi i parë në Shqipërin e lirë, u bë pas 48 vjetëve, për t'u çmallur me gjithë fisin dhe dy motrat e tij, të cilat i munguan për gjysmë shekulli në rrugët e mërgimit. Amerika e George Washingtonit, do të bëhej atdheu i dytë.

Ceremonia mortore u zhvillua në xhaminë e Garfield - Nju Xhersit, drejtuar nga Imam Nasuf Hoxha dhe Gëzim Hysen Agolli. Varrimi i tij u bë në varrezat qytetare në kompleksin "Baron Hirsch Cemetery", në Staten Island (Nju Jork).

BEQIR SINA, New York

MB - Botime dhe Studio Grafike sjell për lexuesit visare dibrane
të mbledhura e të përpunuara mjeshtërisht nga Naim Plaku.
Alegoria, tregimi, fantazia... përmblidhen në një vëllim prej 176 faqesh

AURORA GROUP SH.P.K

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet



Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

"Risku" sh.p.k.
Market "Ken"

Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394



m&b - botime & studio grafike

hap kolanën "Urtësi dibrane"
me vëllimin "PO TË MOS ISHTE DRINI..."
me autor Naim Plakun

...Vidani hapi prapë sytë. Para tij qëndronte Seta, gruaja e ëndrrave të tij, Seta e butë, Seta e egër, Seta e bukur, nusja e tij e re, duke përkëdhelur mes gishtërinjve të bardhë unazën e çmuar, që e kishte ruajtur në gjirin e saj tash sa mote. I mori dorën e majtë Vidanit, ia afroi mbi zemrën e saj që gufonte, ia vuri në gisht, lidhi dorën e saj me të Vidanit, siç i kishte të lidhura unaza, i puthi dorën e përgjakur ku shkëlqente porosia e Bip Hutës dhe amaneti i madh i Gjergjit. Të dy ranë në lëndinë si dy krahët e këputur të shqipes mbi gjoks të njëri-tjetrit. Kur Seta u zgjua, Vidani qëndronte si gjeth i verdhë në krahët e saj. Sa i lehtë ishte bërë ky burrë vigan! Seta i hapi aty një gropë me tehun e shpatës së Martinit. E mbuloi me dheun e shkriftë të zallit dhe e lagu me lotët e syve të kaltër. Këtu, po, vërtet këtu është dhe Varri i Vidanit. Po varri i Setës, vallë, ku është?! Ka vdekur Seta apo është akoma gjallë e rron mes nesh?!

Çmimi: 500 lekë*

* Për porositë nëpërmjet telefoni (04) 22 33 283 përfitoni 20% zbritje.
Për jashtë shtetit shumës së shitjes i shtohen shpenzimet postare

Grafika: ***Studio "m&b"***. Tel: (04) ***2233 283***.